

PSE DUHEN PYETUR TË RINJTË?

ANALIZË MBI POZITËN E
TË RINJVE NË ULQIN



Titulli i publikimit:
PSE DUHEN PYETUR TË RINJTË?
(Analizë mbi pozitën e të rinjve në Ulqin)



Botues:

OJQ Horizonti i Ri

Rr. Kodra pn, Ulqin

Tel: +382 68 300 603

E-mail: ngohorizonti@t-com.me

www.ngo-horizonti.org

 newhorizonngo

Për botuesin:

Nazif Veliqi

Grupi punues:

Admira Metoviq

Gabriela Ivanoviq

Nazif Veliq

Konsulenca profesionale:

Hakile Resulbegoviq

Faqosja dhe dizajni:

Azemina Hasanaga

Shtypi:

Promotive – Podgoricë

*Kjo analizë është pjesë e projektit
"Liderët e rinj: nga ideja te
ndikimi", i cili zbatohet nga OJQ
Horizonti i Ri në partneritet me
organizatën "Këndi i Tolerancës",
me mbështetjen financiare të
Ministrit të Sportit dhe Rinisë.
Përmbajtja e këtij publikimi është
përgjegjësi ekskluzive e autorëve
dhe në asnjë mënyrë nuk
pasqyron qëndrimet e donatorit*

Ulqin, korrik 2026.



Mali i Zi
Ministria e Sportit
dhe Rinisë

HYRJE:

Pse duhen pyetur të rinjtë?

Një qytet nuk matet vetëm nga numri i banorëve, gjatësia e vijës bregdetare apo sezoni turistik. Ai matet edhe nga hapësira dhe mundësitë që u ofron brezave që do ta trashëgojnë atë. Në këtë kuptim, çështja e pozitës së të rinjve në Ulqin nuk është vetëm çështje e një brezi, por një çështje që lidhet drejtpërdrejt me të ardhmen e qytetit: kush do të zgjedhë të jetojë këtu, kush do ta zhvillojë atë, kush do të sjellë ide të reja dhe nëse të rinjtë do ta shohin Ulqinin si një vend mundësish apo si një vend nga i cili duhet të largohen.

Ulqini është një qytet me identitet të fortë, histori të pasur dhe një diversitet kulturor mjaft të theksuar. Si një komunë bregdetare dhe shumëkulturëshe, ai ka një dinamikë të veçantë shoqërore: është njëkohësisht komunitet lokal, destinacion turistik, qytet kufitar dhe një pikëtakimi ku gërshetohen gjuhë, kultura, breza dhe stile të ndryshme jetese. Pikërisht për këtë arsye, pozita e të rinjve në Ulqin nuk mund të trajtohet në mënyrë sipërfaqësore. Të rinjtë këtu nuk e ndajnë jetën thjesht mes shkollës, familjes dhe kohës së lirë; ata gjenden vazhdimisht mes potencialit të madh që ofron Ulqini dhe kufizimeve që ndiejnë çdo ditë në arsim, punësim, sport, kulturë, pjesëmarrje në jetën publike dhe në mundësitë për të ndikuar në vendimet që i prekin drejtpërdrejt.

Sipas të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2023, komuna e Ulqinit numëron 20.507 banorë. Bazuar në strukturën moshore të publikuar nga MONSTAT-i, grupmosha nga 15 deri në 29 vjeç numëron 3.604 të rinj, çka përbën rreth 17,6% të popullsisë së përgjithshme të komunës. Kjo do të thotë se pothuajse çdo i gjashti banor i Ulqinit i përket një brezi që ndodhet në një fazë jetësore mjaft kritike: pas përfundimit të shkollës, u duhet të zgjedhin fakultetin, të kërkojnë punën e parë, të ndërtojnë identitetin e tyre, të konsolidojnë qëndrimet shoqërore dhe të vendosin nëse të ardhmen e tyre e shohin në qytetin e lindjes, diku tjetër në Mal të Zi apo jashtë vendit.

Këto të dhëna nuk janë thjesht shifra statistikore; ato përfaqësojnë një brez real, zgjedhjet e të cilit do të vulosin të ardhmen e komunitetit. Nëse të rinjtë largohen sepse nuk shohin mjaftueshëm mundësi, qyteti humb shumë më tepër se thjesht banorët. Humb energjinë, dijen, krijimtarinë, lidhjen sociale dhe ata që nesër do të udhëheqin zhvillimin e tij. Në të kundërt, nëse të rinjtë ndiejnë se kanë hapësirë për të mësuar, punuar, për t'u përfshirë dhe për t'u dëgjuar, atëherë qyteti fiton një gjeneratë që nuk i pret ndryshimet nga të tjerët, por i jetëson vetë ato.

Hulumtimi mbi pozitën e të rinjve në Ulqin është ndërmarrë pikërisht nga nevoja që ky zë të dëgjohet më qartë, më konkretisht dhe me më shumë përgjegjësi. Pyetësi u realizua në kuadër të projektit „Liderët e rinj: nga ideja te ndikimi”, i cili zbatohet nga OJQ „Horizonti i Ri” në partneritet me OJQ „Këndi i Tolerancës”, nën mbështetjen e Ministrisë së Sportit dhe Rinisë. Qëllimi i projektit është përmirësimi i pozitës së të rinjve në Mal të Zi përmes pjesëmarrjes aktive dhe liderizmit. Synimi është që ata të pozicionohen si forcë lëvizëse e ndryshimit, e jo thjesht si konsumatorë pasivë të vendimeve të gatshme.

Raporti nisët nga një premisë e thjeshtë: nuk mund të bëhet një diskutim serioz për të rinjtë pa përfshirjen e tyre. Ata janë të parët që e dinë se çfarë u mungon në jetën e përditshme, çfarë i shtyn drejt zhvillimit, ku qëndrojnë barrierat dhe përse po e konsiderojnë gjithnjë e më shumë largimin. Zëri i tyre nuk përfaqëson vetëm qëndrime personale, por është një sinjal i qartë për komunitetin lokal.

Kur të rinjtë flasin për arsimin, ata nuk flasin vetëm për shkollën, por për gatishmërinë e tyre për të nesërmen. Kur flasin për terrene sportive, programe kulturore apo hapësira dedikuara atyre, ata kërkojnë ndjesinë e përkatësisë. Kur flasin për pushtetin lokal dhe vendimmarrjen, ata vënë në pyetje nëse komuniteti i vlerëson si partnerë të barabartë. Dhe kur flasin për largimin, kjo rrallëherë lidhet me mungesën e dashurisë për qytetin e tyre — lidhet me mungesën e sigurisë, të ardhmes dhe të mundësive konkrete.

METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Hulumtimi mbi pozitën e të rinjve në Ulqin, në të cilin morën pjesë 200 të rinj, u realizua me qëllim që të fitohej një pasqyrë më e qartë mbi nevojat, qëndrimet dhe pritshmëritë e tyre lidhur me fushat kryesore të jetës së përditshme dhe zhvillimit të ardhshëm. Në fokus të hulumtimit ishin arsimi, edukimi joformal, koha e lirë, sporti, qasja në aktivitete dhe shërbime për të rinjtë, pjesëmarrja në jetën shoqërore, mundësitë për zhvillim, si dhe synimet e tyre për të emigruar. Vëmendje e veçantë iu kushtua mënyrës se si të rinjtë i vlerësojnë mundësitë që ofron komuniteti lokal, sa të përfshirë ndihen në proceset e vendimmarrjes dhe cilat ndryshime i konsiderojnë më të rëndësishme për ta parë Ulqinin si një vend ku mund të ndërtojnë të ardhmen e tyre.

Në hulumtimin e zhvilluar gjatë periudhës prill–qershor 2026 morën pjesë 200 të rinj nga Ulqini. Rrjedhimisht, hulumtimi shërben si bazë për një kuptim më të mirë të nevojave, qëndrimeve dhe përvojave të tyre, si dhe për hartimin e rekomandimeve të mbështetura në përgjigjet e pjesëmarrësve.

Për qëllimet e hulumtimit është përdorur një pyetësor i strukturuar, i përbërë nga pyetje të mbyllura dhe të hapura. Pyetjet e mbyllura mundësojnë një pasqyrim sasior të qëndrimeve të të rinjve përmes opsioneve të paraformuluara të përgjigjeve, ndërsa pyetjet e hapura u japin hapësirë të anketuarve që të shprehin me fjalët e tyre se çfarë u mungon, çfarë aftësish dëshirojnë të zhvillojnë dhe cilat ndryshime i konsiderojnë më kryesore për qëndrimin e të rinjve në Ulqin.

Pyetësori përfshin disa pjesë tematike. Pjesa e parë ka të bëjë me karakteristikat demografike të të anketuarve, duke përfshirë moshën, gjininë, vendbanimin dhe statusin aktual. Pjesa e dytë fokusohet tek arsimi dhe aftësitë, konkretisht në vlerësimin se sa sistemi arsimor i përgatit të rinjtë për tregun e punës, si dhe në përvojat e tyre me trajnimet dhe edukimin jashtëshkollor. Pjesa e tretë trajton kohën e lirë, sportin dhe disponueshmërinë e aktiviteteve sportive, kulturore dhe edukative. Pjesa e katërt lidhet me pjesëmarrjen e të rinjve, angazhimin e tyre të deritanishëm në iniciativa dhe gatishmërinë për t'u përfshirë në projekte që u mundësojnë të ndikojnë në vendimet e qytetit. Pjesa përfundimtare e pyetësorit i dedikohet synimeve të emigrimit, përkatësisht planeve të të rinjve lidhur me vendbanimin e tyre të ardhshëm dhe faktorëve që i shtyjnë ata t'i kërkojnë mundësitë jashtë Ulqinit.

Rezultatet janë paraqitur përmes frekuencave dhe përqindjeve, gjë që mundëson një pasqyrë të qartë të qëndrimeve dominuese dhe modeleve të përgjigjeve të të rinjve. Në rastin e pyetjeve me disa opsione përgjigjesh, secili opsion i ofruar është analizuar si kategori më vete, me qëllim që të paraqitet më saktë se sa shpesh të rinjtë identifikojnë arsye të caktuara për largimin nga qyteti i tyre.

Përpunimi i të dhënave është kryer përmes procedurave të statistikës deskriptive. Për pyetjet e mbyllura, janë analizuar frekuencat e përgjigjeve dhe përqindja e pjesëmarrjes së secilës kategori. Për pyetjet e vlerësimit (si shkalla e kënaqësisë, përgatitja për tregun e punës, qasja në aktivitete dhe gjasat e largimit), rezultatet janë interpretuar duke u nisur nga shpërndarja e përgjigjeve dhe modelët mbizotërues në qëndrimet e të anketuarve. Pyetjet e hapura janë analizuar në mënyrë tematike, duke i grupuar përgjigjet sipas elementeve më të përsëritura dhe tërësive kuptimore.

Kjo analizë ka mundësuar që, përkrah treguesve numerik, të pasqyrohen edhe mesazhet konkrete të të rinjve mbi atë se çfarë u nevojitet, çfarë u mungon dhe çfarë konsiderojnë si kyçe për përmirësimin e pozitës së të rinjve në Ulqin.



200

të rinj nga Ulqini



**prill–qershor
2026.**

Periudha e zhvillimit
të hulumtimit



**Pyetësor i
strukturuar**


Kombinim i pyetjeve të
mbyllura dhe të hapura

PROFILI I PJESËMARRËSVE: ZËRI I TË RINJVE NGA QYTETI DHE FSHATI

Për të kuptuar se çfarë mendojnë të rinjtë e Ulqinit për qytetin e tyre, së pari duhet të zbulojmë se kush fshihet pas këtyre opinioneve. Pas çdo përqindjeje në këtë hulumtim, qëndron një zë i gjallë: i një nxënësi a studenti, i një të riu në punë apo në kërkim të saj; i dikujt që jeton në zemër të qytetit apo në zonat rurale; i një të riu që të ardhmen e sheh në Ulqin, apo i një tjetri që tashmë i ka sytë nga largimi. Pikërisht kjo larmi e bën hulumtimin kaq me vlerë; pozita e të rinjve nuk është unike, ndaj as nevojat e tyre nuk mund të thjeshtohen në një pasqyrë të vetme.

Në analizën e këtij hulumtimi u përfshinë 200 të rinj nga Ulqini. Të gjithë pjesëmarrësit dhanë përgjigje të vlefshme për pyetjet bazë demografike, çka mundëson një pasqyrim të qartë të strukturës së kampionit sipas moshës, gjinisë, vendbanimit dhe statusit aktual. Moshë e të anketuarve varion nga 14 deri në 30 vjeç, me një moshë mesatare prej 21.1 vjeç. Kjo e dhënë tregon se hulumtimi ka përfshirë kryesisht të rinj që ndodhen në fazën e tranzicionit — mes arsimimit, përvojave të para të punës dhe marrjes së vendimeve të rëndësishme për jetën. Kjo është pikërisht perioda kur më së shumti formohen qëndrimet nëse komuniteti lokal ofron hapësirë të mjaftueshme për zhvillim, mësim, punë dhe pavarësim.

Grafiku 1: Gjinia




Struktura moshore e pjesëmarrësve tregon se në hulumtim janë të përfaqësuar breza të ndryshëm të rinjsh, që nga nxënësit e shkollave të mesme e deri te të rriturit që tashmë kanë hyrë tashmë në tregun e punës ose janë në fazën e përfundimit të studimeve. Të anketuarit më të rinj janë të moshës 14 dhe 15 vjeç, ndërsa moshë më e madhe arrijnë deri në 30 vjeç. Pjesën më të madhe të kampionit e përbëjnë të rinjtë në fund të adoleshencës dhe në fillim të të njëzetave. Sipas shpërndarjes kumulative, rreth tri të katërtat e pjesëmarrësve i përket grupmoshës 24 vjeç e poshtë, ndërsa pothuajse nëntë nga dhjetë të anketuar janë deri në 26 vjeç. Kjo do të thotë se rezultatet vënë në dukje veçanërisht perspektivën e asaj gjenerate që ndodhet përpara zgjedhjeve që lidhen me arsimin, vazhdimin e shkollimit, punësimin, aktivizmin dhe shpërnguljen e mundshme.




Sipas gjinisë, në hulumtim morën pjesë 146 vajza, përkatësisht 73,0% e kampionit, dhe 54 djem, ose 27,0% e kampionit. Kjo strukturë tregon një përfaqësim më të lartë të vajzave ndër pjesëmarrësit e hulumtimit, gjë që duhet pasur parasysh gjatë interpretimit të rezultateve. Pjesëmarrja e lartë e vajzave mund të shihet edhe si një sinjal i rëndësishëm i gatishmërisë së tyre për të marrë pjesë në diskutimet mbi pozitën e të rinjve dhe zhvillimin shoqëror. Gjatë analizës së mëtejshme, do të analizohen sipas gjinisë qëndrimet e të rinjve, sidomos aty ku mund të ketë diferenca në vlerësimin e mundësive për zhvillim, pjesëmarrjen në iniciativë, aktivizimin sportiv apo synimet për të emigruar.

Grafiku 2: Vendbanimi



Sa i përket vendbanimit, shumica e pjesëmarrësve vijnë nga zona urbane e Ulqinit. Gjithsej 130 të anketuar, përkatësisht 65,1%, kanë deklaruar se jetojnë në qytet, ndërsa 70 të anketuar, ose 34,9%, jetojnë në fshat. Ky raport është veçanërisht i rëndësishëm pasi nevojat e të rinjve nga zonat urbane dhe ato rurale mund të jenë të ndryshme. Të rinjtë që jetojnë në fshatra shpesh mund të përballen me sfida shtesë lidhur me disponueshmërinë e transportit, të aktiviteteve arsimore e kulturore, veprimtarive sportive, hapësirave të takimit dhe mundësive për pjesëmarrje të përditshme në iniciativat lokale. Nga ana tjetër, ndonëse të rinjtë nga qyteti mund të kenë akses më të afërt me institucionet dhe aktivitetet, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se ata i konsiderojnë ato të mjaftueshme, cilësore apo të përshtatshme për nevojat e tyre. Prandaj, ndarja mes qytetit dhe fshatit është e rëndësishme për të kuptuar dallimet lokale brenda vetë komunës.

Grafiku 3: Statusi aktual



Sipas statusit aktual, grupin më të përfaqësuar e përbëjnë nxënësit, të cilët janë 79, përkatësisht 39,7% e pjesëmarrësve në hulumtim. Studentët përbëjnë 33,3%, ose gjithsej 67 të anketuar. Të rinjtë e punësuar janë 46, çka përfaqëson 22,8% të numrit të përgjithshëm, ndërsa 8 të anketuar, ose 4,2%, kanë deklaruar se janë të papunë. Struktura e paraqitur është mjaft e dobishme për interpretimin e rezultateve, pasi përfshin të rinj në pozita të ndryshme jetësore. Nxënësit mund të flasin më qartë për përvojën shkollore, aktivitetet jashtëshkollore




dhe nevojat për programe dhe aktivitete shtesë. Studentët mund të identifikojnë sfidat e vazhdimin të arsimit, të largimit nga qyteti dhe të planifikimit të karrierës së ardhshme. Të rinjtë e punësuar kanë një përvojë më të drejtpërdrejtë me tregun e punës, ndërsa të rinjtë e papunë mund të vënë në dukje në mënyrë veçanërisht të qartë pengesat në punësim dhe në zhvillimin profesional.

Vlen të theksohet se nxënësit dhe studentët përbëjnë gati tre të katërtat e numrit të përgjithshëm. Për rrjedhojë, gjetjet pasqyrojnë kryesisht zërin e të rinjve që janë ende pjesë e sistemit arsimor. Kjo u jep një rol të veçantë vlerësimeve të tyre mbi rolin e shkollës në përgatitjen për tregun e punës, aftësitë që duan të përvetësojnë dhe vizionin e tyre se ku dëshirojnë ta ndërtojnë të ardhmen.

Duke përfshirë në mostrën e anketës, si të rinj të punësuar ashtu edhe të papunë, hulumtimi shkon përtej realitetit të nxënësve dhe studentëve. Pjesëmarrësit sjellin përvoja reale nga përballja me tregun e punës dhe pasigurinë profesionale. Ky këndvështrim është jetik për të kuptuar emigrimin, pasi dëshira për të qëndruar në vendlindje kushtëzohet drejtpërdrejt nga mundësitë për të ndërtuar një jetë të qëndrueshme dhe të pavarur.

Struktura e pjesëmarrësve tregon se hulumtimi përfshin disa perspektiva të rëndësishme të rinisë në Ulqin: zërin e nxënësve të shkollave të mesme që sapo hyjnë në sferën e vendimmarrjes shoqërore, zërin e studentëve që mendojnë për arsimimin dhe karrierën e ardhshme, zërin e të rinjve të punësuar që tashmë po sprovojnë mundësitë lokale, si dhe zërin e të rinjve të papunë që ballafaqohen me kufizimet e tregut të punës. Përfshirja e të rinjve nga qyteti dhe fshati e zgjeron edhe më tej këtë pasqyrë, duke bërë që pozita e rinisë të mos vlerësohet vetëm nga këndvështrimi i qendrës urbane, por nga hapësira më e gjerë lokale e mbarë komunës.

Profili i paraqitur i pjesëmarrësve ofron një bazë të qëndrueshme për të kuptuar rezultatet që vijojnë në vazhdim të raportit. Ai dëshmon se hulumtimi nuk i referohet një grupi të vetëm e homogjen të rinjsh, por një brezi që shfaq larmishmëri të brendshme, por që ndan të njëjtat pikëpyetje: a u hap arsimi dyer drejt së ardhmes, a ka mjaftueshëm aktivitete në qytet, a dëgjohen ata nga institucionet, a gjejnë hapësirë për t'u aktivizuar dhe a është Ulqini një vend ku mund ta imagjinojnë jetën e tyre. Pikërisht për këtë arsye, profili demografik nuk shërben thjesht si një hyrje teknike për rezultatet, por është treguesi i parë i gjerësisë dhe rëndësisë së zërave që janë grumbulluar përmes këtij hulumtimi.




ARSIMI DHE AFTËSITË: SA I PËRGATIT SISTEMI TË RINJTË PËR TË ARDHMEN?

Arsimi është ndër ato tema ku pasqyrohet më së miri se si të rinjtë e shohin të ardhmen e tyre. Kur ata flasin për shkollën, kurset, trajnimet digjitale apo përgatitjen për punë, në të vërtetë po ngrenë një pyetje shumë më të madhe: a po i përgatit sistemi për jetën që i pret, apo po i braktis në mëshirë të fatit pikërisht në çastin kur duhet të marrin vendimet më të rëndësishme për shkollimin, karrierën, pavarësinë dhe qëndrimin në qytetin e tyre?

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se të rinjtë në Ulqin nuk e shohin arsimin si krejtësisht të pamjaftueshëm, por as si mbështetje të fortë që i përgatit për tregun e punës. Në pyetjen se në çfarë mase konsiderojnë se arsimi i përgatit për tregun e punës, numri më i madh i të anketuarve pohon se i përgatit „mesatarisht”. Në pamje të parë, një përgjigje e tillë mund të duket neutrale. Megjithatë, kur bëhet fjalë për të rinjtë dhe pritshmëritë e tyre, ajo nxjerr në dritë një pyetje thelbësore: nëse shkolla i përgatit ata vetëm pjesërisht për tregun e punës, kush e mbush zbrazëtinë mes teorisë në klasë dhe aftësive reale që kërkon jeta dhe profesioni?

Grafiku 4: Në çfarë mase i përgatit sistemi arsimor të rinjtë për tregun e punës?




Sipas rezultateve të hulumtimit, 40,6% e të anketuarve konsiderojnë se arsimi i përgatit mesatarisht për tregun e punës. 21,9% e tyre deklarojnë se i përgatit pak, ndërsa 8,0% mendojnë se nuk i përgatit aspak. Domethënë, pothuajse tre në dhjetë të rinj kanë një qëndrim kritik ndaj shkallës në të cilën sistemi arsimor i përgatit për punësimin e ardhshëm, ndërsa gjithsej 70,6% e të rinjve e vlerësojnë atë si „mesatar”. Nga ana tjetër, 24,6% e të anketuarve konsiderojnë se arsimi i përgatit në masë të madhe, dhe vetëm 4,8% se i përgatit plotësisht.

Të dhënat nxjerrin në pah një mospërputhje të madhe mes sistemit arsimor dhe nevojave reale të të rinjve për t'u përballur me tregun e punës. Kjo nuk nënkupton se të rinjtë e nënvlerësojnë rëndësinë e shkollës dhe të arsimit formal. Përkundrazi, nga përgjigjet e tyre kuptohet se arsimi u ofron një bazë të fortë, por nuk i përgatit aq sa duhet për rrugëtimin që nis pas bankave të shkollës apo fakultetit. Të rinjtë e pranojnë se, përveç njohurive teorike, u nevojiten edhe aftësi praktike, si për shembull: si të shkruajnë një CV, si të prezantohen para punëdhënësit, si të komunikojnë, si të përdorin mjetet digjitale, si t'i menaxhojnë financat, si ta planifikojnë karrierën, si të ndërmarrin një iniciativë dhe si të marrin vendime.

Kjo dukuri përfaqëson diçka mjaft aktuale për Ulqinin. Në komunitete më të vogla, ku mundësitë arsimore dhe profesionale janë më të kufizuara se në qendrat e mëdha, mungesa e përgatitjes praktike rrit ndjeshëm pasigurinë te rinia. Nëse mungojnë praktikatat, këshillimi për karrierë dhe lidhja konkrete me tregun e punës, ikja nga vendlindja nuk shihet më si opsion, por si rrugëdalja e vetme logjike. Prandaj, në këtë hulumtim, tema e arsimit nuk kufizohet te muret e shkollës; ajo është një pyetje e hapur mbi qëndrimin, zhvillimin dhe besimin te e ardhmja.


Grafiku 5: Pjesëmarrja e të rinjve në edukimin joformal



Rezultatet mbi edukimin joformal shfaqin anën tjetër, shumë më optimiste, të së njëjtës histori. Plot 92,6% e të rinjve deklarojnë se kanë marrë pjesë në aktivitet jashtëshkollorë, si p.sh. kurse, punëtori, aksione ekologjike, trajnime apo projekte rinore. Vetëm 7,4% e të anketuarve tregojnë se nuk kanë pasur një përvojë të tillë. Kjo e dhënë na ndihmon të kuptojmë pozitën e të rinjve në Ulqin, pasi tregon se ata nuk janë pasivë dhe nuk presin që zhvillimi të ndodhë vetvetiu. Në fakt, shumica prej tyre kërkojnë vazhdimisht mundësi shtesë për të mësuar jashtë sistemit të arsimit formal.

Një përqindje kaq e lartë e pjesëmarrjes në edukimin joformal pasqyron nevojën e fortë të të rinjve për aktivitete dhe programe shtesë që janë praktike, të aksesueshme dhe më pranë interesave të tyre reale. Edukimi joformal në këtë hulumtim shfaqet si një urë lidhëse mes asaj që ofron shkolla dhe asaj që u nevojitet të rinjve për zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Kurset, punëtoritë, trajnimet dhe projektet rinore nuk janë thjesht aktivitete shtesë. Për shumë të rinj, ato përfaqësojnë një hapësirë ku mund të rrisin vetëbesimin, të krijojnë njohje të reja, të fitojnë aftësi konkrete, të qartësojnë interesat e tyre dhe të ndiejnë se mund të jenë pjesë aktive e komunitetit.

Grafiku 6: Sa u ka ndihmuar të rinjve edukimi jashtëshkollor?



Rezultatet e nxjerra nga grafiku i mësipërm tregojnë impaktin që ka pasur edukimi joformal tek të rinjtë. Pothuajse gjysma e të anketuarve, përkatësisht 49,7%, deklarojnë se pjesëmarrja në edukimet jashtëshkollorë u ka ndihmuar shumë për të mësuar diçka të re apo për të fituar aftësi të dobishme. Një pjesë tjetër prej 33,3% konsideron se kjo u ka ndihmuar në masë të madhe. Marrë së bashku, kjo do të thotë se 83,0% e të rinjve njohin një shkallë të lartë të dobishmërisë së arsimit joformal. Nga ana tjetër, 14,3% e tyre shprehen se u ka ndihmuar pak, ndërsa vetëm 2,6% mendojnë se nuk u ka ndihmuar fare.




Ky rezultat përputhet me projektin „Liderët e rinj: nga ideja te ndikimi”. Nga këtu kuptojmë se të rinjtë vlerësojnë pikërisht ato forma pune që ndodhen në qendër të programeve rinore: punëtoritë, trajnimet, edukimet praktike, aktivitetet udhëheqëse dhe projektet që nuk i trajtojnë të rinjtë thjesht si nxënës, por si pjesëmarrës aktivë. Kur më shumë se tetë në dhjetë të rinj thonë se edukimi jashtëshkollor u ka ndihmuar shumë ose në masë të madhe, ky është një argument i fuqishëm se investimi në edukimin joformal nuk është një aktivitet dytësor, por një instrument kyç për zhvillimin e rinisë.

Vlera e vërtetë e këtyre rezultateve qëndron në kontrastin që ato nxjerrin në pah mes dy përvojave të ndryshme. Arsimi formal shihet si pjesërisht i dobishëm për tregun e punës, trajnimet dhe aktivitetet joformale vlerësohen jashtëzakonisht pozitivisht. Mesazhi kryesor këtu nuk është se njëra duhet të zëvendësojë tjetrën, por se ato duhet të plotësojnë njëra-tjetrën. Shkolla dhe fakulteti vendosin themelet, ndërsa programet e edukimit joformal janë ato që i shndërrojnë këto themele në aftësi praktike, duke u dhënë të rinjve sigurinë dhe gatishmërinë që u duhet për t’u përballur me jetën reale.

Shkolla dhe fakulteti vendosin themelet, ndërsa programet e edukimit joformal janë ato që i shndërrojnë këto themele në aftësi praktike, duke u dhënë të rinjve sigurinë dhe gatishmërinë që u duhet për t’u përballur me jetën reale.

Grafiku 7: Aftësitë që të rinjtë duan të mësojnë në këto aktivitete



Përgjigjet e hapura tregojnë se të rinjtë e kanë të qartë se çfarë dëshirojnë të mësojnë. Përgjigjet e tyre nuk përmbledhen në një kategori të vetme, por shfaqin një spektër të gjerë interesash dhe nevojash. Të rinjtë kërkojnë njohuri që lidhen me teknologjitë bashkëkohore, tregun e punës, zhvillimin personal, shëndetin mendor, komunikimin, kreativitetin, aktivizmin dhe jetën e përditshme. Pikërisht këto përgjigje kaq të larmishme dëshmojnë se të rinjtë në Ulqin nuk mjaftohen vetëm me sasinë e aktiviteteve, por kërkojnë programe më cilësore, praktike dhe të mirëorganizuara për rritjen e tyre.

Një nga fushat me më shumë interesim janë aftësitë digjitale dhe të IT-së, gjë që është e dukshme në grupin e parë të grafikut të mësipërm. Në përgjigjet lidhur me këtë shfaqen programimi, inteligjenca artificiale, njohuritë digjitale, robotika, analiza e të dhënave, siguria kibernetike, dizajni grafik, montazhi i videove dhe përdorimi i platformave digjitale. Këto përgjigje tregojnë se të rinjtë e lidhin të ardhmen e tyre arsimore dhe profesionale drejtpërdrejt me teknologjinë. Për ta, aftësitë digjitale nuk janë thjesht një njohuri shtesë, por një mënyrë për të qenë më konkurrues, më të informuar dhe më të përgatitur për ndryshimet në tregun e punës.



Grupi i dytë i përgjigjeve ka të bëjë me gjuhët e huaja dhe komunikimin. Të rinjtë vënë në dukje nevojën për mësimin e gjuhëve, të folurit publik, debatet, aftësitë prezantuese, gazetarinë, shkrimin, komunikimin dhe negocimin. Këto përgjigje nxjerrin në pah nevojën e të rinjve për të rritur vetëbesimin dhe aftësitë komunikuese. Fakti që këto dy elemente ndërliidhen tregon se ata nuk kërkojnë vetëm njohuri teknike, por edhe mbështetje për zhvillimin e tyre personal.

Grupi i tretë përfaqësohet nga shëndeti mendor dhe zhvillimi personal. Në përgjigje përmenden trajnimet në lidhje me psikologjinë, menaxhimi i stresit, vetëbesimi, jetesa e shëndetshme, ekuilibri, marrëdhëniet ndërpersonale, zgjidhja e konflikteve. Këto përgjigje tregojnë se të rinjtë i dallojnë sfidat emocionale dhe psikologjike të rritjes, shkollimit, punësimit dhe presionit shoqëror. Nevoja për programe të tilla dëshmon se zhvillimi i të rinjve nuk mund të kufizohet vetëm te punësimi; ata kërkojnë mbështetje edhe për të qenë më të sigurt, më rezistentë, më të informuar dhe më të gatshëm për t'u përballur me sfidat e përditshme.

Grupi i katërt i përgjigjeve lidhet me sipërmarrjen dhe edukimin financiar. Të rinjtë veçojnë ndërmarrësinë, nisjen e një biznesi, bazat e financave, kursimin, taksat, kreditë, llogaritë bankare, investimet, menaxhimin e parave, negocimin e pagës. Nga këto përgjigje vërejmë një mesazh mjaft domethënës: të rinjtë kanë nevojë për njohuri praktike që t'i përgatisin për jetën, pavarësinë dhe tregun e punës, tema këto që arsimi formal shpesh i anashkalon.

Grupi i pestë ka të bëjë me punëtoritë kreative dhe aktivitetet artistike. Të rinjtë përmenden fotografinë, dizajnin, muzikën, aktrimin, teatrin, pikturën, vizatimin, punëtoritë e filmit dhe letërsinë, zgjidhjen kreative të problemeve dhe forma të ndryshme të shprehjes artistike. Përgjigjet tregojnë se të rinjtë nuk e shohin zhvillimin vetëm përmes punës dhe tregut të punës, por edhe përmes krijimtarisë, kulturës dhe vetë-shprehjes. Për një qytet si Ulqini, me një identitet të fortë kulturor dhe potencial të madh turistik, nevoja të tilla mund të shërbejnë si një bazë e rëndësishme për zhvillimin e programeve kreative për të rinjtë.

Grupi i gjashtë i përgjigjeve fokusohet te sporti, shëndeti dhe shkathtësitë jetësore. Të rinjtë përmenden sportin, rekreacionin, fitnesin, ushqyerjen e shëndetshme, ndihmën e parë, qëndrimin në natyrë, alpinizmin, mënyrën e shëndetshme të jetesës dhe aftësitë bazë jetësore. Përgjigjet tregojnë se të rinjtë nuk e shohin zhvillimin vetëm përmes arsimit dhe punës, por edhe përmes cilësisë së jetës së përditshme. Nevoja për aktivitete të tilla është veçanërisht e rëndësishme sepse ndërliidh shëndetin fizik, mirëqenien mendore, shoqërimin dhe kalimin e dobishëm të kohës së lirë.

Grupi i shtatë paraqet aktivizmin qytetar, liderizmin dhe pjesëmarrjen në komunitet. Në përgjigje përmenden aktivizmi, liderhipi, vendimmarrja, demokracia, të drejtat e njeriut, të drejtat themelore, funksionimi i institucioneve, vullnetarizmi, projektet lokale, organizimi rinor dhe mënyrat se si të rinjtë mund të marrin pjesë aktive në ndryshime. Ky grup përgjigjesh është veçanërisht i rëndësishëm për projektin, pasi tregon se tek të rinjtë ekziston interesi për të kuptuar se si funksionon shoqëria dhe si mund të ndikojnë në komunitet. Të rinjtë nuk pranojnë të jenë vetëm vëzhgues pasivë në nivel lokal. Ata kanë nevojë për aftësi, hapësirë dhe përkrahje për t'u bërë pjesë e vendimmarrjes.

Nga shqyrtimi i përgjigjeve të hapura buron një panoramë e qartë: rinia e Ulqinit aspirojnë për një sistem arsimor të lidhur ngushtë me praktikën. Kërkesa e tyre shtrihet përtej teorisë – ata kërkojnë aftësi që lehtësojnë punësimin, jetësimin e ideve, komunikimin efektiv dhe inteligjencën emocionale, krahas zotërimit të teknologjisë, jetesës së shëndetshme, kreativitetit dhe qytetarisë aktive. Kjo dëshmon se qasjet e fragmentuara dhe ndërhyrjet e rastësishme janë të pamjaftueshme. Zgjidhja kërkon një platformë të integruar bashkëpunimi, ku ndërveprojnë në mënyrë të vazhdueshme shkollat, vetëqeverisja lokale, organizatat joqeveritare, komuniteti i biznesit, ekspertët dhe vetë të rinjtë.

Prandaj, ky kapitull mbart një nga mesazhet kryesore të hulumtimit: rinia e Ulqinit dëshiron të rritet profesionalisht, por kërkon aktivitete praktike dhe aktuale. Duke investuar te ky potencial, arsimi joformal mund të kthehet në shtyllën kryesore për përmirësimin e pozitës së të rinjve. Përmes edukimit joformal mund të zbutet hendeku arsim-punësim, të rritet vetëbesimi i të rinjve dhe të dalin në skenë liderët e ardhshëm, të cilët nuk do të mjaftohen vetëm me planifikimin e jetës së tyre, por do të bëhen bashkëautorë në ndërtimin e së ardhmes së qytetit.


Të rinjtë nuk pranojnë të jenë vetëm vëzhgues pasivë në nivel lokal. Ata kanë nevojë për aftësi, hapësirë dhe përkrahje për t'u bërë pjesë e vendimmarrjes

Përmes edukimit joformal mund të zbutet hendeku arsim-punësim, të rritet vetëbesimi i të rinjve dhe të dalin në skenë liderët e ardhshëm, të cilët nuk do të mjaftohen vetëm me planifikimin e jetës së tyre, por do të bëhen bashkëautorë në ndërtimin e së ardhmes së qytetit.

KOHA E LIRË, SPORTI DHE PËRMBAJTJET PËR TË RINJTË: NJË QYTET ME POTENCIAL, POR ME MUNGESË HAPËSIRASH TË MJAFTUESHME

Ulqini mbart një potencial të jashtëzakonshëm natyror e bregdetar, të gërshetuar me një mozaik të pasur kulturor. Megjithatë, përgjigjet e të rinjve tregojnë se jeta e tyre e përditshme nuk mund të ndërtohet vetëm mbi potencialin. Potenciali i një qyteti shndërrohet në një vlerë reale vetëm atëherë kur të rinjtë kanë ku të ushtrojnë sport, ku të mblidhen, ku të mësojnë, ku të krijojnë, ku ta kalojnë kohën e lirë. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se të rinjve në Ulqin nuk u mungon interesimi për të bërë një jetë aktive. Përkundrazi, një numër i madh i tyre merren me sport ose aktivitete rekreative. Problemi qëndron në faktin se hapësirat, infrastruktura dhe përmbajtjet e organizuara nuk i përgjigjen në masë të mjaftueshme kësaj nevojë.

Grafiku 8: A merreni me sport?




Në pyetjen nëse merren me sport apo aktivitete rekreative, pothuajse gjysma e të anketuarve (49,7%) deklarojnë se këto aktivitete i zhvillojnë herë pas here. 38,9% shprehen se merren rregullisht me sport ose rekreacion. Kjo do të thotë se pothuajse nëntë në dhjetë të rinj janë të angazhuar në një formë të aktivitetit fizik. Vetëm 11,1% e të anketuarve deklarojnë se nuk merren fare me sport ose rekreacion. Ky është një tregues shumë i rëndësishëm, pasi dëshmon se te të rinjtë ekziston një vetëdije e zhvilluar për rëndësinë e aktivitetit fizik, shëndetit dhe nevojës për lëvizje. Të rinjtë nuk janë një grup që duhet bindur për rëndësinë e sportit; ata tashmë tregojnë interes dhe angazhim në praktikë. Ajo që mungon është një sistem që e mbështet këtë motivim përmes hapësirave të qasshme, infrastrukturës cilësore dhe përmbajtjeve të larmishme.

Struktura e përgjigjeve tregon se sporti dhe rekreacioni për të rinjtë në Ulqin nuk lidhen vetëm me garat ose me ushtrimin profesional të sportit. Për shumicën, aktiviteti fizik është pjesë e jetës së përditshme, një mënyrë për t'u shoqëruar, për të çliruar stresin, për të mbrojtur shëndetin dhe për ta kaluar kohën e lirë në mënyrë të dobishme. Veçanërisht domethënë është fakti se grupi më i madh i të rinjve përbëhet nga ata që merren me sport herë pas here. Kjo është një kategori që, me shumë gjasë, ka interesim për aktivitet fizik, por jo domosdoshmërisht kushtet e vazhdueshme, rutinën, oraret e përshtatshme, mbështetjen ose infrastrukturën e nevojshme që sporti të bëhet pjesë më e rregullt e jetës së tyre. Marrja me sport në mënyrë të rastësishme mund të shihet si një tregues i potencialit ekzistues, i cili ende nuk mbështetet në masën e duhur.



Grafiku 9: A mendon se në Ulqin ka mjaftueshëm aktivitete dhe hapësira sportive (si fusha, palestra, qendra sportive)?



Kur ky tregues lidhet me vlerësimin e të rinjve për disponueshmërinë e infrastrukturës sportive, krijohet një pasqyrë shumë më e qartë e situatës. Nga të anketuarit që dhanë përgjigje të vlefshme në pyetjen nëse në Ulqin ka mjaftueshëm objekte dhe përmbajtje sportive, vetëm 6,6% vlerësojnë se ato janë të mjaftueshme. Në të kundërt, 59,9% e të rinjve mendojnë se Ulqini nuk ka mjaftueshëm përmbajtje sportive, ndërsa 31,9% shprehen se ato janë vetëm pjesërisht të mjaftueshme. Një 1,6% deklarojnë se nuk kanë një qëndrim të caktuar.


Është veçanërisht e rëndësishme që përgjigjja “pjesërisht” të mos interpretohet si një rezultat plotësisht pozitiv. Kur pothuajse një e treta e të rinjve thonë se përmbajtjet sportive janë vetëm pjesërisht të mjaftueshme, kjo zakonisht nënkupton se disa mundësi ekzistojnë, por ato nuk janë të mjaftueshme, nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë, nuk ofrojnë cilësinë e nevojshme, nuk janë mjaftueshëm të larmishme ose nuk u përgjigjen nevojave të grupeve të ndryshme të të rinjve. Në praktikë, kjo mund të nënkuptojë se ekzistojnë palestra shkollore, disa fusha sportive ose klube sportive, por mungojnë hapësirat publike dhe të qasshme për rekreacion, terrenet moderne, pishina, salla sportive, zonat rekreative, përmbajtjet për sporte të ndryshme dhe hapësirat që nuk lidhen ekskluzivisht me klubet sportive ose institucionet arsimore.

Fakti që pothuajse gjashtë nga dhjetë të rinj konsiderojnë se në Ulqin nuk ka mjaftueshëm përmbajtje sportive është veçanërisht domethënës për një qytet me karakteristika si Ulqini. Kushtet natyrore të qytetit – bregdeti, plazhet, lumi, liqeni si dhe hapësirat e përshtatshme për lëvizje dhe aktivitete në natyrë, përbëjnë një bazë të fuqishme për zhvillimin e programeve sportive, rekreative dhe rinore. Megjithatë, përgjigjet e të rinjve tregojnë se potenciali natyror, në vetvete, nuk është i mjaftueshëm. Të rinjtë kanë nevojë për infrastrukturë të mirëfilltë, të rregulluar dhe të qasshme, si terrene sportive, salla, palestra, pishina, klube, zona rekreative, hapësira për stërvitje dhe aktivitete që janë në dispozicion gjatë gjithë vitit, e jo vetëm në mënyrë sezonale ose të përkohshme.

Përgjigjet e hapura në pyetjen se çfarë u mungon më së shumti të rinjve në Ulqin e përforcojnë edhe më tej këtë tablo. Të rinjtë përmendin shpesh mungesën e fushave sportive, një qendre sportive, një salle sportive, një pishine, hapësirave rekreative, hapësirave publike më cilësore, parqeve, vendeve për shoqërim, një qendre rinore, programeve kulturore dhe edukative, kinemasë, teatrit, koncerteve, punëtorive kreative, aktiviteteve për të rinjtë dhe përmbajtjeve të organizuara gjatë muajve të dimrit.

Përgjigjet e të rinjve tregojnë se potenciali natyror, në vetvete, nuk është i mjaftueshëm. Të rinjtë kanë nevojë për infrastrukturë të mirëfilltë, të rregulluar dhe të qasshme, si terrene sportive, salla, palestra, pishina, klube, zona rekreative, hapësira për stërvitje dhe aktivitete që janë në dispozicion gjatë gjithë vitit, e jo vetëm në mënyrë sezonale ose të përkohshme.

Grafiku 10: Përmbajtjet që u mungojnë më së shumti të rinjve në Ulqin – paraqitje tematike




Klasifikimi paraprak sipas temave të përgjigjeve të hapura tregon se nevojat e të rinjve grupohen më së shpeshti rreth disa fushave kryesore. Grupi i parë paraqet programet edukative dhe punëtoritë. Të rinjtë përmendin shpesh programe edukative, punëtori, kurse, programe të orientimit në karrierë, zhvillimin e aftësive digjitale, programet e vullnetarizmit dhe aktivitete që do t'i ndihmonin të zhvillohen edhe përtej arsimit formal. Ata nuk e shohin kohën e lirë vetëm si kohë për pushim, por edhe si një mundësi për të mësuar, për t'u zhvilluar dhe për t'u përgatitur për të ardhmen.

Grupi i dytë lidhet me hapësirat për të rinjtë. Në përgjigje shfaqen shpesh shprehje si "hapësira për të rinjtë", "qendër rinore", "hapësira sociale", "vende takimi", "hapësira coworking" dhe ambiente ku të rinjtë mund të mësojnë, të diskutojnë, të organizojnë aktivitete, të kalojnë kohën e lirë dhe të bashkëpunojnë. Kjo është ndoshta një nga mesazhet më të rëndësishme të këtij kapitulli: të rinjtë nuk kërkojnë vetëm një aktivitet tjetër në kalendar, por një hapësirë të përhershme ku mund të ndihen se përkasin. Një hapësirë rinore nuk është vetëm një ndërtesë; ajo është një vend sigurie, identifikimi, takimi, shkëmbimi idesh dhe veprimi të përbashkët.

Grupi i tretë përfaqëson infrastrukturën sportive. Të rinjtë përmendin nevojën për fusha sportive, qendra sportive, pishinë, zona rekreative, klube sportive, terrene për futboll, basketboll e tenis, salla dhe pajisje sportive. Në shumë përgjigje vihet re edhe kërkesa që këto përmbajtje të jenë më të qasshme, më të larmishme dhe më pak të varura nga hapësirat ekzistuese shkollore. Një pjesë e të rinjve theksojnë gjithashtu dimensionin financiar të pjesëmarrjes në sport, veçanërisht kur aktivitetet sportive për fëmijët dhe të rinjtë paraqesin një barrë ekonomike për familjet. Kjo tregon se politikat rinore në fushën e sportit nuk duhet të kufizohen vetëm në ndërtimin ose rinovimin e objekteve sportive, por duhet të përfshijnë edhe çështje si aksesimi, kostoja, oraret, mbështetja për klubet sportive, sponsorizimet dhe garantimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrje.

Një hapësirë rinore nuk është vetëm një ndërtesë; ajo është një vend sigurie, identifikimi, takimi, shkëmbimi idesh dhe veprimi të përbashkët.



Grupi i katërt lidhet me programet kulturore. Të rinjtë përmendin përmbajtje kulturore, koncerte, projeksione filmash, teatër, ekspozita, punëtori kreative, programe artistike dhe muzikore, aktivitete për nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët, si dhe hapësira për projekte krijuese. Këto përgjigje tregojnë se të rinjtë në Ulqin dëshirojnë një jetë kulturore më të pasur, veçanërisht një ofertë që nuk kufizohet vetëm në sezonin turistik. Programet kulturore për të rinjtë nuk janë vetëm formë argëtimi; ato janë pjesë e identitetit të qytetit dhe një mundësi që të rinjtë të zhvillojnë kreativitetin, të krijojnë lidhje, të marrin pjesë në jetën publike dhe ta përfjetrojnë qytetin si një vend që i frymëzon.

Grupi i pestë, më i ngushtë por me rëndësi të madhe simbolike, tregon kinemanë, teatrin dhe koncertet. Në përgjigje përsëriten shpesh kërkesa për kinema, kinema në qytet, kinema për të rinjtë, projeksione filmash, teatër, shfaqje teatrale, koncerte dhe mbrëmje muzikore. Këto kërkesa pasqyrojnë mungesën e përvojave urbane dhe kulturore, të cilat për të rinjtë në qytetet më të mëdha janë zakonisht më të qasshme. Kur përmendin kinemanë apo teatrin, të rinjtë nuk shprehin thjesht dëshirën për argëtim, por kërkesën që Ulqini të ofrojë një jetesë cilësore edhe jashtë sezonit turistik, duke krijuar hapësira socializimi dhe aktivitete që e mbajnë komunitetin aktiv.

Grupi i gjashtë i përgjigjeve lidhet me sezonalitetin. Të rinjtë theksojnë se Ulqini pulson nga jeta gjatë verës, por mbetet "bosh" dhe me një ofertë tejet të kufizuar gjatë dimrit. Ky konstatim është thelbësor për politikën lokale, pasi tregon se sfida nuk qëndron te numri i aktiviteteve, por te shpërndarja e tyre e barabartë gjatë vitit. Meqenëse rinia jeton këtu në çdo stinë, nevoja për hapësira dhe programe të vazhdueshme mbetet e pranishme gjatë gjithë vitit.

Për këtë arsye, pozita e të rinjve në fushën e kohës së lirë nuk mund të reduktohet vetëm në pyetjen nëse organizohen apo jo aktivitete. Pyetje shumë më e rëndësishme është nëse të rinjtë kanë infrastrukturën e përditshme që u mundëson një jetë cilësore. A kanë një hapësirë ku mund të mblidhen pa presionin e konsumit? A kanë qasje në terrene sportive? A kanë përmbajtje kulturore që nuk organizohen vetëm herë pas here? A kanë mundësi të zhvillojnë talentet e tyre? A kanë vende për të mësuar, për të bërë vullnetarizëm, për punë krijuese dhe për iniciativa të përbashkëta? Përgjigjet e të rinjve tregojnë qartë se nevoja për këto përmbajtje është e fortë dhe shumëdimensionale.

Kur këto përmbajtje mungojnë, të rinjtë mund ta përfjetrojnë qytetin si një vend tranziti, e jo si një mjedis ku mund të zhvillohen dhe të ndërtojnë të ardhmen e tyre.

Programet kulturore për të rinjtë nuk janë vetëm formë argëtimi; ato janë pjesë e identitetit të qytetit dhe një mundësi që të rinjtë të zhvillojnë kreativitetin, të krijojnë lidhje, të marrin pjesë në jetën publike dhe ta përfjetrojnë qytetin si një vend që i frymëzon.




**Edukimi dhe
punëtoritë**



**Sporti dhe
rekreacioni**



Kultura dhe arti



Në këtë kuptim, koha e lirë nuk është një temë dytësore. Ajo lidhet ngushtë me shëndetin mendor, aktivitetin fizik, marrëdhëniet shoqërore, parandalimin e pasivitetit, zhvillimin e aftësive, pjesëmarrjen qytetare dhe prirjen drejt emigrimit. Një qytet pa perspektivë për të rinjtë rrezikon t'i humbasë ata shumë më herët se të largohen. Pa një hapësirë ku zëri dhe energjia e tyre vlerësohen, të rinjtë mund të ndihen të huaj në qytetin e vet, edhe pse jetojnë fizikisht aty.

Rezultatet e hulumtimit përcjellin një mesazh të qartë: Ulqini ka të rinj që dëshirojnë të jenë aktivë, por atyre u nevojitet një mbështetje më e fortë nga niveli lokal për ta zhvilluar këtë potencial. Pothuajse nëntë nga dhjetë të rinj merren me sport ose rekreacion rregullisht ose herë pas here, por vetëm një përqindje shumë e vogël konsideron se përmbajtjet sportive janë të mjaftueshme. Të rinjtë identifikojnë si prioritet zhvillimin e infrastrukturës sportive, krijimin e hapësirave rinore, zgjerimin e programeve kulturore dhe edukative, si dhe ofrimin e aktiviteteve gjatë gjithë vitit. Kjo do të thotë se investimet në hapësirat rinore, në infrastrukturën sportive dhe kulturore, si edhe në programe të rregullta për të rinjtë, mund të kenë një ndikim shumë më të gjerë sesa thjesht rritja e numrit të aktiviteteve. Ato mund të forcojnë ndjenjën e përkatësisë, besimin në komunitetin lokal dhe motivimin e të rinjve për të qenë aktivë dhe për të ndërtuar të ardhmen e tyre në qytet.

Të rinjtë nuk kërkojnë thjesht aktivitete, por një hapësirë ku ndiejnë përkatësi. Kjo fjali përmbledh më së miri thelbin e këtij kapitulli. Për të rinjtë e Ulqinit, koha e lirë nuk është kohë boshe. Ajo është hapësira ku ndërtohen identiteti, miqësitë, shëndeti, vetëbesimi, krijimtaria dhe lidhja me qytetin. Nëse Ulqini synon të jetë një qytet ku të rinjtë zgjedhin të qëndrojnë, atëherë duhet të jetë edhe një qytet që ofron hapësira, mundësi dhe kushte për të qenë aktivë gjatë gjithë vitit.

Një qytet pa perspektivë për të rinjtë rrezikon t'i humbasë ata shumë më herët se të largohen.

Për të rinjtë e Ulqinit, koha e lirë nuk është kohë boshe. Ajo është hapësira ku ndërtohen identiteti, miqësitë, shëndeti, vetëbesimi, krijimtaria dhe lidhja me qytetin.




PJESËMARRJA E TË RINJVE: DUAN TË JENË AKTIVË, POR NUK NDIHEN TË PËRFSHIRË SA DUHET.

Nëse arsimi është hapësira ku të rinjtë fitojnë njohuri, ndërsa koha e lirë është hapësira ku ata zhvillojnë interesimet dhe ndjenjën e përkatësisë, atëherë pjesëmarrja është hapësira ku të rinjtë bëhen të dukshëm si qytetarë. Pikërisht për këtë arsye, çështja e përfshirjes së të rinjve është një nga temat qendrore të këtij hulumtimi. Ajo nuk lidhet vetëm me faktin nëse të rinjtë marrin pjesë herë pas here në projekte ose aktivitete, por me pyetjen nëse ata kanë një ndjenjë reale se mund të ndikojnë në vendimet që formësojnë jetën e tyre të përditshme në Ulqin.

Rezultatet tregojnë një tension të qartë ndërmjet dy gjetjeve të rëndësishme. Një numër i konsiderueshëm i të rinjve konsiderojnë se pushteti lokal nuk i përfshin mjaftueshëm në vendimmarrjet që lidhen me interesat e tyre, ndërsa shumica e të rinjve tregojnë një nivel të lartë të përvojës personale dhe gatishmërisë për të marrë pjesë në iniciativa të ndryshme. Pikërisht në këtë dallim qëndron një nga mesazhet më të rëndësishme të hulumtimit: problemi nuk është se të rinjtë nuk janë të interesuar, por mungesa e kanaleve të hapura dhe të qarta, ku zëri i tyre të cilëve zëri i tyre mund të ketë ndikim real.


Grafiku 11: Përqindja e përfshirjes së të rinjve në vendimet lokale




Në pyetjen nëse mendojnë se pushteti lokal i përfshin të rinjtë në vendimet që prekin interesat e tyre, pothuajse gjysma e të anketuarve, përkatësisht 48,1%, janë përgjigjur negativisht. Një pjesë tjetër prej 22,2% konsideron se të rinjtë përfshihen vetëm pjesërisht. Kjo do të thotë se gjithsej 70,3% e të rinjve nuk e shohin përfshirjen e rinisë si mjaftueshëm të qartë, të fortë apo të plotë. Vetëm 20,6% e të anketuarve konsiderojnë se pushteti lokal i përfshin të rinjtë, ndërsa 9,0% nuk janë të sigurt ose nuk dinë si ta vlerësojnë nivelin ekzistues të përfshirjes.

Të dhënat tregojnë për një hapësirë serioze për përmirësimin e marrëdhënieve midis të rinjve dhe institucioneve lokale. Kur pothuajse çdo i dyti i anketuar i ri thotë se pushteti lokal nuk i përfshin të rinjtë në vendimet që i prekin ata, kjo nuk duhet parë thjesht si një kritikë ndaj institucioneve, por si një sinjal se kanalet ekzistuese të komunikimit nuk janë mjaftueshëm të dukshme, të qasshme apo bindëse për të rinjtë. Madje edhe aty ku ekzistojnë forma të caktuara të përfshirjes, të rinjtë mund të mos i njohin ato si një hapësirë reale për të pasur ndikim. Kjo do të thotë që pjesëmarrja nuk duhet të jetë thjesht një formalitet, por një proces ku të rinjtë ndihen të mirëpritur, dëgjohen dhe shohin që propozimet e tyre sjellin ndryshime konkrete.

Pjesëmarrja nuk duhet të jetë thjesht një formalitet, por një proces ku të rinjtë ndihen të mirëpritur, dëgjohen dhe shohin që propozimet e tyre sjellin ndryshime konkrete.




Grafiku 12: Pjesëmarrja e deritanishme e të rinjve në iniciativa, projekte apo aktivitete




Është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se kjo gjetje nuk do të thotë se të rinjtë janë të shkëputur nga jeta shoqërore. Në pyetjen nëse kanë marrë pjesë personalisht në ndonjë iniciativë, projekt apo aktivitet që lidhet me pozitën e të rinjve, 66,1% e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht. Një e treta e të rinjve, përkatësisht 33,9%, kanë deklaruar se deri më tani nuk kanë pasur një përvojë të tillë.

Kjo e dhënë është mjaft e rëndësishme për projektin „Liderët e rinj: nga ideja te ndikimi”, sepse tregon se tek të rinjtë ekziston një përvojë paraprake pjesëmarrjeje dhe një bazë e shëndoshë mbi të cilën mund të ndërtohen forma më të avancuara të aktivizmit rinor. Të rinjtë që kanë marrë pjesë tashmë në iniciativa mund të kalojnë më lehtë nga roli i thjeshtë i pjesëmarrësit në rolin e nismëtarit të aktiviteteve, të edukatorëve bashkëmoshatarë, të liderëve rinorë apo të përfaqësuesve të të rinjve në proceset lokale. Nga ana tjetër, e treta e të rinjve që ende nuk ka marrë pjesë në aktivitete të tilla përfaqëson një terren me vlerë për zgjerimin e programeve rinore dhe për përfshirjen e atyre që deri më tani nuk kanë pasur mundësi, informacion, mbështetje apo motivim për t'u bërë pjesë e tyre.

Grafiku 13: A do të ishit të interesuar të merrnit pjesë në projekte apo iniciativa që u mundësojnë të rinjve të ndikojnë në vendimmarrjen në qytet?



Në pyetjen nëse do të ishin të interesuar të merrnin pjesë në projekte apo iniciativa që u mundësojnë të rinjve të ndikojnë në vendimet e qytetit, 64,9% e përgjigjeve të vlefshme janë „po”, ndërsa 31,9% përgjigjen „ndoshta”. Vetëm 3,2% e të rinjve deklarojnë se nuk do të ishin të interesuar për një formë të tillë pjesëmarrjeje. Plot 96,8% e të rinjve shprehin të paktën hapje ndaj pjesëmarrjes, qoftë përmes një gatishmërie të qartë, qoftë përmes mundësisë për t'u përfshirë nën kushtet e përshtatshme.




Kjo gjetje është një nga mesazhet më pozitive të hulumtimit. Të rinjtë në Ulqin nuk shfaqin indiferencë. Shumica dërmuese e tyre tregon gatishmëri për t'u bërë pjesë e proceseve që u mundësojnë të ndikojnë në vendimet e qytetit. Kategoria „ndoshta” këtu është veçanërisht e rëndësishme, pasi ajo nuk nënkupton refuzim. Ajo shpesh mund të nënkuptojë se të rinjtë dëshirojnë më shumë informacion, një ftesë më të qartë, një temë konkrete, një organizim më të mirë, siguri se koha e tyre nuk do të shpërdorohet kot ose një dëshmi se pjesëmarrja e tyre do të ketë kuptim. Pikërisht për këtë arsye, „ndoshta” duhet lexuar si një derë e hapur dhe jo si mungesë interesimi.


Kur shqyrtohen së bashku vlerësimi i përfshirjes së të rinjve, pjesëmarrja e tyre e deritanishme dhe gatishmëria për pjesëmarrje në të ardhmen, dallohet qartë një paradoks i pjesëmarrjes. Të rinjtë kanë përvojë dhe motivim, por nuk ndihen mjaftueshëm të përfshirë në proceset formale të vendimmarrjes. Kjo do të thotë se energjia ekziston, por asaj i mungon një kanal më i qëndrueshëm institucional. Të rinjtë duan të marrin pjesë, por u nevojitet më shumë hapësirë ku pjesëmarrja e tyre nuk do të jetë thjesht simbolike, por e lidhur me tema reale, vendime lokale dhe rezultate të dukshme.

Diferenca mes vullnetit të të rinjve për të vepruar dhe perceptimit të tyre mbi shkallën e përfshirjes përbën një sfidë kritike për pushtetin lokal. Neglizhimi i kësaj sfide mund të ushqejë një tërheqje apatike nga jeta publike. Megjithatë, duke e parë këtë situatë si një mundësi zhvillimi, ajo mund të shndërrohet në shtyllën kryesore për ndërtimin e instrumenteve të reja bashkëpunuese. Ndër to veçohen: këshillat dhe konsultimet rinore, buxheti i pjesëmarrës për iniciativat e tyre, thirrjet publike për ide, aksionet lokale dhe takimet e rregullta mes rinisë dhe strukturave vendimmarrëse.

Grafiku 14: Niveli i kënaqësisë së të rinjve mbi mundësitë e zhvillimit personal



Çështja e kënaqësisë me mundësitë e zhvillimit të të rinjve në Ulqin e thellon edhe më tej këtë pasqyrë. Numri më i madh i të anketuarve, prej 42,3%, mban një qëndrim neutral. Të njëjtën përqindje prej 42,3% e përbëjnë edhe të rinjtë që janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me mundësitë e zhvillimit: ku 30,7% janë të pakënaqur, ndërsa 11,6% janë shumë të pakënaqur. Vetëm 12,7% e të rinjve janë të kënaqur, ndërsa 2,6% janë shumë të kënaqur. Pra, vetëm 15,3% e të rinjve shfaqin një nivel pozitiv kënaqësie me mundësitë e zhvillimit në Ulqin.




Kënaqësia me mundësitë e zhvillimit është e ndërlidhur me të gjitha temat e mëparshme të hulumtimit: arsimin, aftësitë, sportin, aktivitetet kulturore, hapësirat për të rinjtë, punësimin dhe pjesëmarrjen. Të rinjtë nuk e vlerësojnë zhvillimin vetëm përmes një dimensionit. Për ta, zhvillim do të thotë mundësi për të fituar aftësi të dobishme, për të pasur qasje në programe cilësore, për t'u marrë me sport, për të pasur një jetë kulturore dhe shoqërore, për të siguruar një mundësi punësimi, për t'u dëgjuar nga institucionet dhe për të pasur mundësi ndikimi në vendimet e qytetit të tyre. Prandaj, pakënaqësia me mundësitë e zhvillimit nuk është një gjetje e izoluar, por një tregues i përgjithshëm i një ndjenje më të gjerë të kufizimit të mundësive.

Pikërisht për këtë arsye, pjesëmarrja e të rinjve nuk duhet të kuptohet si një shtojcë e politikës rinore, por si baza e saj. Nëse të rinjtë nuk përfshihen në hartimin e zgjidhjeve, ekziston rreziku që programet për të rinjtë të mos u përgjigjen nevojave reale. Të rinjtë në këtë hulumtim tregojnë qartë se kanë çfarë të thonë, andaj i identifikojnë problemet, vënë në dukje mangësitë konkrete dhe shfaqin gatishmëri për të marrë pjesë. Detyra e autoriteteve lokale nuk është thjesht t'i ftojë të rinjtë në aktivitete, por të zhvillojë së bashku me ta politika, programe dhe hapësira që u përgjigjen përvojave të tyre.


Rezultatet tregojnë për një potencial të fortë pjesëmarrjeje të të rinjve. Ndonëse një numër i konsiderueshëm prej tyre nuk dallon hapësirë të mjaftueshme për të ndikuar në vendimet lokale, shumica shfaq gatishmëri për t'u përfshirë në iniciativë që u mundësojnë të kontribuojnë në ndryshimet në qytet. Kjo gatishmëri përbën një burim të rëndësishëm për Ulqinin. Ajo dëshmon se mes të rinjve ekziston një energji që mund të orientohet drejt zhvillimit lokal, por vetëm nëse njihet, organizohet dhe mbështetet.

Për projektin „Liderët e rinj: nga ideja te ndikimi“, këto gjetje janë veçanërisht domethënëse. Ato konfirmojnë se zhvillimi i aftësive udhëheqëse nuk është një nevojë abstrakte, por një përgjigje konkrete ndaj gjendjes ekzistuese. Të rinjtë duan të marrin pjesë, por u nevojitet mbështetje për t'i shndërruar idetë e tyre në iniciativë, pakënaqësinë e tyre në propozime dhe përvojën e tyre në ndikim shoqëror. Nëse të rinjve u ofrohen njohuritë, hapësira dhe besimi, pjesëmarrja mund të shndërrohet në diçka shumë më tepër se një përfshirje e rastësishme në projekt; ajo mund të bëhet një mënyrë përmes së cilës të rinjtë marrin një rol më aktiv në zhvillimin e Ulqinit.

Detyra e autoriteteve lokale nuk është thjesht t'i ftojë të rinjtë në aktivitete, por të zhvillojë së bashku me ta politika, programe dhe hapësira që u përgjigjen përvojave të tyre.




QËLLIMET PËR TË EMIGRUAR: LARGIMI SI PASOJË E MUNGESËS SË PERSPEKTIVËS, PAVARËSISHT DASHURISË PËR QYTETIN.



Asgjë që lidhet me të rinjtë nuk peshon aq shumë sa tema e largimit. Kur një i ri thotë se pas shkollës apo fakultetit do të preferonte të jetonte gjetkë, kjo nuk do të thotë se ai nuk e do qytetin e tij. Shpesh, kjo nënkupton se ai thjesht nuk sheh një perspektivë të qartë aty. Pikërisht për këtë arsye, synimet e të rinjve në Ulqin për të emigruar duhen analizuar me kujdes, jo si një vendim i thjeshtë individual, por si një tregues i një ndjenje më të gjerë që lidhet me mundësitë, sigurinë, zhvillimin dhe përkatësinë.

Ulqini është një qytet me identitet të fuqishëm, kulturë të pasur dhe një lidhje të veçantë me hapësirën. Për shumë të rinj, ai nuk është thjesht një vendbanim, por vendi i origjinës, i familjes, i gjuhës, i shoqërisë dhe i historisë personale. Përgjigjet e të rinjve dëshmojnë se lidhja emocionale me qytetin nuk mjafton nëse nuk ekzistojnë mundësi reale për arsimim, punë, zhvillim, jetë kulturore e sportive, pjesëmarrje në vendimarrje dhe për një jetesë të përditshme me dinjitet.


Grafiku 15: Ku do të dëshiroje të jetoje pas përfundimit të shkollës apo fakultetit?




Në pyetjen se ku do të dëshironin të jetonin pas përfundimit të shkollës apo fakultetit, 35,4% e të rinjve deklarojnë se do të dëshironin të jetonin në Ulqin. Kjo e dhënë është e rëndësishme sepse tregon se një pjesë e konsiderueshme e të rinjve megjithatë e sheh Ulqinin si një vend të mundshëm për të ardhmen e tyre. Kjo do të thotë se lidhja e të rinjve me qytetin ekziston dhe se ideja e qëndrimit nuk është zhdukur. Megjithatë, 20,1% e të anketuarve deklarojnë se do të dëshironin të jetonin në ndonjë qytet tjetër në Mal të Zi, ndërsa 25,9% e shohin të ardhmen e tyre jashtë vendit. Një pjesë tjetër prej 18,5% nuk janë ende të sigurt se ku do të dëshironin të jetonin.

Të dhënat tregojnë se e ardhmja e të rinjve në Ulqin mbetet një çështje e hapur. Nga njëra anë, më shumë se një e treta e të rinjve duan të qëndrojnë në qytet, gjë që përbën një potencial të rëndësishëm për komunitetin lokal. Nga ana tjetër, pothuajse gjysma e të rinjve tashmë po e orientojnë të ardhmen e tyre drejt një qyteti tjetër në Mal të Zi ose jashtë vendit. Kur kësaj i shtohet edhe pothuajse një e pesta e atyre që nuk janë të sigurt, bëhet e qartë se vendimi për të qëndruar është ende duke u formësuar te një numër i madh të rinjsh. Pikërisht ky grup i të rinjve të pavendosur është veçanërisht i rëndësishëm për politikat lokale, pasi vendimi i tyre mund të varet nga fakti nëse Ulqini do të ofrojë më shumë mundësi konkrete për zhvillim në vitet e ardhshme.

Pavendosmëria e të rinjve nuk duhet të interpretohet si dobësi apo mungesë interesimi. Ajo mund të jetë një shenjë se të rinjtë ende po peshojnë midis ndjenjës së përkatësisë ndaj qytetit dhe nevojës për mundësi më të mira. Ata ndoshta duan të qëndrojnë, por nuk janë të sigurt nëse do t'i kenë kushtet për këtë. Prandaj, çështja e synimeve për të emigruar është njëkohësisht edhe një çështje besimi: a besojnë të rinjtë se në Ulqin mund të ndërtohet e ardhmja?



Grafiku 16: Sa e mundshme është që në të ardhmen të jetosh jashtë Ulqinit?



Një pasqyrë edhe më e qartë fitohet përmes pyetjes se sa ka gjasë që të rinjtë në të ardhmen të jetojnë jashtë Ulqinit. Vetëm 6,9% e të anketuarve deklarojnë se nuk ka fare gjasë që të jetojnë jashtë Ulqinit. Një pjesë tjetër prej 33,3% konsideron se kjo ka pak gjasë. Ndërkaq, 36,5% e të rinjve vlerësojnë se ka gjasë që në të ardhmen të jetojnë jashtë Ulqinit, ndërsa 23,3% mendojnë se kjo ka shumë gjasë. Pra, mund të thuhet se 59,8% e të rinjve vlerësojnë se ka gjasë ose ka shumë gjasë që në të ardhmen të jetojnë jashtë Ulqinit.

Kjo gjetje është një nga më të rëndësishmet në të gjithë hulumtimin. Kjo nuk do të thotë se të gjithë këta do të largohen me të vërtetë, e as që largimi është domosdoshmërisht përfundimtar. Të mendosh për emigrimin nuk do të thotë se do të largohesh nesër, por kur gjashtë në dhjetë të rinj deklarojnë se ka shumë gjasë të jetojnë jashtë Ulqinit, ky është një alarm i qartë për komunitetin lokal. Një e dhënë e tillë dëshmon se shumë të rinj aktualisht nuk e shohin Ulqinin si një mjedis të qëndrueshëm sa duhet për planifikimin afatgjatë të jetës.

Është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se largimi i të rinjve nuk është thjesht një çështje demografike. Ai është i lidhur ngushtë me arsimin, punësimin, cilësinë e shërbimeve publike, jetën kulturore dhe sportive, ndjenjën e drejtësisë, përfshirjen në vendimmarrje dhe mundësinë që të rinjtë të zhvillojnë potencialin e tyre. Kur të rinjtë nuk shohin arsye për të qëndruar, qyteti nuk humb thjesht numra në statistika; ai humb kapitalin njerëzor, forcën inovative, prindërit dhe liderët e së ardhmes.

Kur të rinjtë nuk shohin arsye për të qëndruar, qyteti nuk humb thjesht numra në statistika; ai humb kapitalin njerëzor, forcën inovative, prindërit dhe liderët e së ardhmes.




Tabela 1. Tendanca largimit të të rinjve nga Ulqini sipas grupmoshave

Grupmosha	Tendanca e ulët e largimit	Tendanca e lartë e largimit
14–18 vjeç	78.1%	21.9%
19–24 vjeç	21.8%	78.2%
do 30 vjeç	19.1%	80.9%

Shënim: Përqindjet janë llogaritur brenda secilës grupmoshë. Testi Hi-katror tregon një lidhje statistikisht domethënëse midis grupmoshës dhe prirjes për t'u larguar: $\chi^2(2)=57.94$, $p<.001$, Cramer's $V=.554$.

Analiza shtesë dëshmon se tendanca e largimit ndryshon sipas grupmoshave. Një aspiratë të tillë e shfaqin fillimisht 21,9% e të rinjve nga 14 deri në 18 vjeç, por shifra rritet ndjeshëm në 78,2% midis të rinjve të moshës 19-24 vjeç dhe prek vlerën 80,9% te grupmosha deri në 30 vjeç. Ky trend konfirmon se dëshira për të emigruar përforcohet në momentin e tranzicionit drejt studimeve të larta, punësimit dhe jetës së pavarur.

Tabela 2. Tendanca e largimit të të rinjve nga Ulqini sipas vendbanimit

Vendbanimi	Tendanca e ulët e largimit	Tendanca e lartë e largimit
Qytet	52.0%	48.0%
Fshat	18.2%	81.8%

Shënim: Janë paraqitur përqindjet brenda kategorive të vendbanimit. Testi Hi-katror tregon një lidhje me rëndësi statistikore ndërmjet vendbanimit dhe rrezikut të largimit: $\chi^2(1)=20.47$, $p<.001$, Cramer's $V=.329$.

Tendanca e largimit është më e theksuar tek të rinjtë nga zonat rurale. Midis të rinjve që jetojnë në qytet, një prirje të lartë largimi e shfaqin 48,0% e tyre, ndërsa tek të rinjtë nga fshati kjo përqindje arrin në 81,8%. Kjo gjetje tregon se të rinjtë nga zonat rurale mund të kenë një ndjenjë më të theksuar të kufizimit të mundësive, gjë që duhet marrë parasysh gjatë planifikimit të programeve rinore, transportit, aktiviteteve sportive dhe qasshmërisë së aktiviteteve jashtë qendrës urbane.


Tabela 3. Tendanca e largimit të të rinjve nga Ulqini sipas vlerësimit të përfshirjes së të rinjve në vendimmarrjen lokale

Shkalla e përfshirjes së të rinjve	Tendanca e ulët e largimit	Tendanca e lartë e largimit
Po	92.3%	7.7%
Pjesërisht	69.0%	31.0%
Jo	7.7%	92.3%

Shënim: Janë paraqitur përqindjet brenda kategorive të vlerësimit të përfshirjes së të rinjve. Kategorisë „Nuk e di” nuk i është bërë analizë. Testi Hi-katror tregon një lidhje me rëndësi statistikore ndërmjet vlerësimit të përfshirjes së të rinjve në vendimmarrjen lokale dhe rrezikut të largimit: $\chi^2(2)=97.19$, $p<.001$, Cramer's $V=.752$.

Një nga gjetjet shtesë më të fuqishme lidhet me marrëdhënien midis ndjenjës së përfshirjes së të rinjve dhe tendencës së largimit. Midis të rinjve që konsiderojnë se pushteti lokal i përfshin të rinjtë në vendime, prirje të lartë largimi kanë vetëm 7,7%. Midis atyre që mendojnë se të rinjtë përfshihen vetëm pjesërisht, kjo përqindje është 31,0%. Përkundrazi, midis të rinjve që vlerësojnë se pushteti lokal nuk i përfshin të rinjtë, plot 92,3% e tyre bëjnë pjesë në grupin me rrezik të lartë largimi.

Grafiku 17: Arsyet e kërimit të mundësive jashtë qytetit të vet



Pyetjet mbi faktorët që ndikojnë tek të rinjtë për të kërkuar mundësi jashtë qytetit të tyre tregojnë më tej se synimet për migrim nuk janë rezultat i vetëm një arsyeje, por i kombinimit të disa faktorëve të ndërlidhur mes vete. Arsyeja më e shpeshtë e përmendur është mungesa e mundësive për avancim dhe zhvillim të të rinjve, të cilën e kanë theksuar 84,1% e të anketuarve. Ky është një tregues jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse tregon se të rinjtë e lidhin largimin kryesisht me ndjenjën e mundësive të kufizuara. Për shumicën e të rinjve, problemi nuk qëndron vetëm në një sektor apo një institucion të caktuar, por në përshtypjen më të gjerë se qyteti nuk ofron hapësirë të mjaftueshme për zhvillim personal, arsimor dhe profesional.

Faktori i dytë më i shpeshtë është mungesa e mundësive arsimore, të cilën e kanë përmendur 54,0% e të rinjve. Ky rezultat është veçanërisht i rëndësishëm për Ulqinin, pasi lidhet drejtpërdrejt me gjetjet e mëparshme mbi arsimin dhe aftësitë. Të rinjtë e kuptojnë se vazhdimi i shkollimit, përmirësimi i mëtejshëm profesional dhe qasja në programe që i përgatisin për të ardhmen shpesh kërkojnë largimin në mjedise të tjera. Kur një i ri duhet të largohet nga qyteti për të studiuar, për të fituar aftësi të caktuara, për të mësuar gjuhë të huaja, për të zhvilluar kompetenca digjitale ose për t'u përfshirë në programe më cilësore, largimi mund të shndërrohet nga një hap i përkohshëm arsimor në një vendim afatgjatë jetësor.

Faktori i tretë i rëndësishëm është punësimi. Vështirësinë për të gjetur punë si arsye për largim e kanë përmendur 51,3% e të rinjve. Kjo do të thotë se më shumë se gjysma e të anketuarve e lidhin largimin me problemet e punësimit. Për të rinjtë, puna është shumë më tepër sesa vetëm një burim të ardhurash. Ajo përfaqëson mundësinë për pavarësi, siguri, planifikim të familjes, zgjidhje të çështjes së banimit, ndërtim të identitetit profesional dhe ndjenjës së vlerës personale. Nëse të rinjtë nuk shohin mundësi që në Ulqin të gjejnë një punë që përputhet me kualifikimet, interesimet dhe pritshmëritë e tyre, atëherë qytetet e tjera dhe jashtë vendit bëhen një alternativë më reale.

Mungesën e aktiviteteve kulturore, argëtuese dhe sportive si faktor për largim e kanë përmendur 40,7% e të rinjve. Ky rezultat tregon se synimet për migrim nuk lidhen vetëm me punësimin dhe arsimin. Cilësia e jetës luan një rol të rëndësishëm në vendimin e të rinjve për të qëndruar apo për t'u larguar. Ata kërkojnë përmbajtje gjatë gjithë vitit, hapësira për takime, ngjarje kulturore e sportive, programe kreative, kinema, koncerte, mundësi për rekreacion dhe vende ku mund të kalojnë kohën e lirë, pa ndjenjën se qyteti është aktiv vetëm gjatë sezonit turistik. Kur këto mundësi mungojnë, largimi nuk shihet vetëm si kërkim për një vend pune, por edhe si kërkim për një jetë më të plotë.


Kushtet e pafavorshme shoqërore si faktor për largim i kanë përmendur 34,9% e të anketuarve, ndërsa 33,3% e të rinjve konsiderojnë se në tendencën për largimin e tyre ndikon edhe përfshirja e pamjaftueshme e të rinjve në proceset vendimmarrëse. Këto të dhëna hapin një dimension të rëndësishëm shoqëror të migrimit. Të rinjtë nuk e konsiderojnë largimin vetëm për arsye ekonomike, por edhe për shkak të perceptimit të tyre mbi klimën shoqërore, drejtësinë, mundësinë për të ndikuar dhe qasjen e institucioneve ndaj tyre. Kur të rinjtë ndiejnë se nuk kanë zë, se vendimet merren pa pjesëmarrjen e tyre ose se kontributi dhe njohuritë e tyre nuk vlerësohet sa duhet, lidhja e tyre me qytetin zbehet ndjeshëm.

Pikërisht këtu synimet për migrim lidhen me pjesëmarrjen e të rinjve. Gjetjet e mëparshme kanë treguar se një numër i konsiderueshëm i të rinjve nuk mendojnë se pushteti lokal i përfshin ata sa duhet në vendimet që lidhen me interesat e tyre. Tani shohim se një e treta e të rinjve e identifikon pikërisht përfshirjen e pamjaftueshme në vendimmarrje si një nga faktorët që i shtyn të kërkojnë mundësi jashtë qytetit. Kjo do të thotë se përfshirja e të rinjve nuk është vetëm çështje e kulturës demokratike, por edhe çështje e qëndrimit të tyre në vend.


Faktorin “tjetër” e kanë zgjedhur 2,6% e të rinjve, por përgjigjet e hapura tregojnë se pas këtyre arsyeve shtesë shpesh qëndrojnë tema që i thellojnë gjetjet kryesore: punësimi partiak, nepotizmi, largimi i miqve, rrethanat e pafavorshme shoqërore dhe mungesa e programeve cilësore për të rinjtë. Edhe pse këto përgjigje shfaqen më rrallë, ato janë të rëndësishme sepse tregojnë çështjen e besimit në sistemin lokal. Të rinjtë nuk vlerësojnë vetëm nëse ekziston një vend pune, por edhe nëse qasja ndaj punësimit është e drejtë. Ata nuk vlerësojnë vetëm nëse ekzistojnë programe, por edhe nëse ato janë cilësore dhe të arritshme. Ata nuk vlerësojnë vetëm nëse mund të qëndrojnë, por edhe nëse qëndrimi do të nënkuptonte një mundësi të barabartë dhe të drejtë për zhvillim.

Kur të rinjtë ndiejnë se nuk kanë zë, se vendimet merren pa pjesëmarrjen e tyre ose se kontributi dhe njohuritë e tyre nuk vlerësohet sa duhet, lidhja e tyre me qytetin zbehet ndjeshëm.

Grafiku 18: Struktura e tendencës për largim



Të dhënat tregojnë se të anketuarit kanë identifikuar disa faktorë njëkohësisht. Përmes pyetjes me zgjedhje të shumëfishtë, nga 200 të rinj janë regjistruar gjithsej 602 përgjigje, çka do të thotë se secili prej tyre ka përmendur mesatarisht rreth tre faktorë që nxisin prirjen për largim. Ky tregues konfirmon se synimet për migrim janë komplekse. Të rinjtë nuk largohen vetëm për shkak të një problemi të vetëm, por si pasojë e ndërthurjes së faktorëve arsimorë, ekonomikë, shoqërorë, kulturorë dhe të përfshirjes në vendimmarrje.



Prandaj, çështja e largimit të të rinjve nga Ulqini nuk mund të zgjidhet me vetëm një masë të vetme. Nuk mjafton hapja e një programi të vetëm, organizimi i disa aktiviteteve ose konsultimi i herëpashershëm me të rinjtë. Nevojitet një qasje më e gjerë, e cila lidh arsimin, punësimin, mësimin joformal, përmbajtjet kulturore dhe sportive, hapësirat për të rinjtë, mundësitë e barabarta dhe përfshirjen reale të të rinjve në proceset vendimmarrëse. Vetëm një qasje e tillë mund t'u përgjigjet arsyeve komplekse për të cilat të rinjtë mendojnë për largimin.

Gjetjet nuk duhet të interpretohen si një mesazh pa shpresë. Fakti që 35,4% e të rinjve dëshirojnë të jetojnë në Ulqin, ndërsa 18,5% ende nuk janë të sigurt, tregon se ekziston hapësirë për veprim. Shumë të rinj ende nuk i kanë mbyllur dyert ndaj mundësisë së qëndrimit. Vendimet e tyre mund të ndryshojnë nëse shohin se ndryshon edhe qyteti, nëse krijohen mundësi të reja, nëse investohet në të rinjtë, nëse krijohen hapësira për zhvillimin e tyre, nëse arsimi lidhet më mirë me praktikën, nëse punësimi bëhet më i drejtë dhe nëse të rinjtë fitojnë një zë të vërtetë në proceset që ndikojnë në jetën e tyre.

Mesazhi më i rëndësishëm i këtij kapitulli është se largimi i të rinjve nuk duhet të shihet si një dështim individual apo si dëshmi se të rinjtë nuk janë të lidhur me Ulqinin. Më e saktë është të thuhet se largimi është një simptomë e mungesës së perspektivës. Të rinjtë që mendojnë të largohen shpesh nuk synojnë thjesht braktisjen e qytetit, por kërkojnë atë që nuk e gjejnë mjaftueshëm në të: mundësi përparimi, arsim cilësor, punësim, jetë aktive shoqërore, drejtësi, përfshirje dhe siguri

Prandaj, pyetja që shtrohet për komunitetin lokal nuk është thjesht se si të parandalohet largimi i të rinjve. Synimi i vërtetë është se si ta kthejmë qëndrimin në një mundësi reale, tërheqëse dhe dinjitoze. Të rinjtë nuk mund të qëndrojnë vetëm për shkak të lidhjes emocionale, familjes apo kujtimeve. Ata zgjedhin të qëndrojnë kur shohin se në qytetin e tyre mund të arsimohen, të punësohen, të krijojnë dhe të ndërtojnë të ardhmen e tyre


ÇFARË MESAZHI JAPIN TË RINJTË: QËNDRIMI DUHET TË BËHET NJË MUNDËSI REALE

Në fakt, problemi i vërtetë që ngrihet nga ky hulumtim nuk është pse të rinjtë synojnë largimin, por se çfarë do t'i bindte ata të ndërtonin të ardhmen këtu. Në këtë pyetje qëndron thelbi i gjithë hulumtimit. Kërkesat e të rinjve për të qëndruar në Ulqin nuk janë abstrakte; ato janë konkrete, reale dhe të lidhura drejtpërdrejt me jetën e përditshme. Ata nuk kërkojnë një qytet të idealizuar apo premtime boshe. Ata duan kushte bazë për të planifikuar të ardhmen, për t'u zhvilluar, punuar e arsimuar, për të kaluar kohën lirë në mënyrë cilësore.

Grafiku 19: Faktorët kryesorë që do të frenonin prirjen e të rinjve për largim nga Ulqini



Analiza tematike të përgjigjeve të hapura tregon se të rinjtë nuk e lidhin qëndrimin në Ulqin vetëm me një fushë të vetme. Përgjigjet e tyre tregojnë qartë se vendimi për të qëndruar varet nga disa kushte të ndërlidhura mes vete, si punësimi, arsimi, përmbajtjet dhe aktivitetet për të rinjtë, hapësirat për tubim dhe bashkëpunim, marrëdhëniet e drejta shoqërore, përfshirja në vendimarrje, infrastruktura dhe cilësia e përgjithshme e jetës.



Mesazhi më i shpeshtë dhe më i fuqishëm lidhet me nevojën për më shumë vende pune cilësore dhe të qëndrueshme. Të rinjtë e lidhin shumë qartë qëndrimin me mundësinë e punësimit. Në përgjigjet e tyre, puna nuk paraqitet vetëm si një nevojë ekonomike, por si bazë e pavarësisë, dinjitetit dhe ndjenjës së sigurisë. Pa një mundësi reale për të gjetur një punë të qëndrueshme, të rinjtë e kanë të vështirë të planifikojnë jetën e tyre në Ulqin, pavarësisht lidhjes emocionale me qytetin. Në këtë kuptim, punësimi nuk është vetëm një kategori e tregut të punës, por një çështje që lidhet me qëndrimin e një gjenerate të tërë. Të rinjtë kërkojnë vende pune që nuk janë vetëm të përkohshme dhe sezonale, por që ofrojnë zhvillim profesional, vazhdimësi dhe ndjenjën se përpjekjet dhe njohuritë e tyre mund të çojnë drejt një të ardhmeje më të sigurt.

Përveç punësimit, një tjetër mesazh shumë i fuqishëm lidhet me nevojën për mundësi më të mira arsimimi. Të rinjtë e ndiejnë se perspektiva e qëndrimit varet në masë të madhe nga fakti nëse në mjedisin lokal ekzistojnë mundësi për të mësuar, për t'u zhvilluar profesionalisht, për të fituar njohuri praktike dhe për të ndërtuar aftësi që janë të rëndësishme për jetën bashkëkohore dhe tregun e punës. Kjo përfshin arsimin formal, por edhe shumë më tepër se kaq: programe jashtëshkollore, trajnime profesionale, aftësi digjitale, mësimin e gjuhëve të huaja, edukim për sipërmarrje, këshillim për karrierë, punëtori praktike dhe lidhje me mundësi konkrete profesionale. Të rinjtë nuk kërkojnë vetëm diploma; ata duan të ndiejnë se njohuritë që fitojnë i çojnë drejt diçkaje konkrete dhe të dobishme. Kur kjo lidhje mungon, mundësia që ata të qëndrojnë në qytet bëhet më e vogël.


Mesazhi i tretë i madh lidhet me nevojën për më shumë përmbajtje dhe aktivitete për të rinjtë. Kjo kërkesë nuk duhet të kuptohet në mënyrë sipërfaqësore, si një dëshirë vetëm për argëtim. Kur të rinjtë thonë se kanë nevojë për më shumë aktivitete, ata flasin për nevojën për një jetë të përditshme më cilësore. Ata kërkojnë aktivitete që përfshijnë ngjarje kulturore, punëtori, debate, programe për të rinjtë, aktivitete kreative, ngjarje shoqërore, edukime dhe hapësira për bashkëpunim e shoqërim që nuk kufizohen vetëm në kafene apo në aktivitetet sezonale. Përgjigjet e tyre tregojnë qartë nevojën që qyteti të mos jetë aktiv vetëm gjatë verës, por t'u ofrojë të rinjve jetë dhe mundësi gjatë gjithë vitit.

Një temë mjaft e përmendur në përgjigjet e të rinjve është nevoja për një qendër rinore dhe hapësira për takime e bashkëpunim. Kjo është një nga ato kërkesa që tejkalon nevojat individuale dhe hap çështjen e ndjenjës së përkatësisë. Të rinjtë kërkojnë një vend tyrin, një hapësirë ku mund të mblidhen, të mësojnë, të organizojnë aktivitete, të zhvillojnë ide, të bashkëpunojnë dhe të kalojnë kohën në mënyrë domethënëse. Qendra rinore, në këtë rast, nuk përfaqëson vetëm një hapësirë fizike, por një simbol marrëdhënieje serioze mes komunitetit dhe të rinjve.

Një rol të rëndësishëm në përgjigjet e të rinjve zënë edhe infrastruktura sportive dhe kulturore. Të rinjtë e theksojnë shumë qartë se cilësia e jetës në qytet nuk varet vetëm nga punësimi dhe arsimi, por edhe nga fakti nëse ata kanë ku të merren me aktivitete rekreative, të stërviten, të krijojnë dhe të kalojnë kohën e lirë. Fushat sportive, sallat, zonat rekreative, parqet, hapësirat kulturore, kinemaja, teatri, koncertet dhe aktivitetet që nxisin kreativitetin nuk janë luks për ta, por pjesë e një jete normale urbane dhe shoqërore. Përmes këtyre përgjigjeve shihet nevoja që Ulqini të jetë një qytet ku të rinjtë jo vetëm jetojnë, por edhe zhvillojnë shprehje jetësore, identitetin e tyre dhe ndjenjën e lidhjes me komunitetin.

Të rinjtë kërkojnë vende pune që nuk janë vetëm të përkohshme dhe sezonale, por që ofrojnë zhvillim profesional, vazhdimësi dhe ndjenjën se përpjekjet dhe njohuritë e tyre mund të çojnë drejt një të ardhmeje më të sigurt.

Të rinjtë kërkojnë një vend tyrin, një hapësirë ku mund të mblidhen, të mësojnë, të organizojnë aktivitete, të zhvillojnë ide, të bashkëpunojnë dhe të kalojnë kohën në mënyrë domethënëse. Qendra rinore, në këtë rast, nuk përfaqëson vetëm një hapësirë fizike, por një simbol marrëdhënieje serioze mes komunitetit dhe të rinjve.



Një nga temat më të ndjeshme, por njëkohësisht shumë të rëndësishme, që shfaqet në përgjigjet e të rinjve lidhet me punësimin e drejtë dhe ndikimin më të vogël partiak. Të rinjtë nuk flasin vetëm për mungesën e vendeve të punës, por edhe për mënyrën se si arrihet deri te punësimi. Në disa përgjigje vërehet qartë nevoja për një sistem më të drejtë, në të cilin njohuritë, përkushtimi dhe kompetencat kanë më shumë peshë sesa lidhjet politike, ndikimi partiak apo rrjetet joformale.

Përveç kësaj, një pjesë e të rinjve thekson qartë nevojën për përfshirje më të madhe në vendimet që lidhen me jetën e tyre dhe zhvillimin e qytetit. Kjo temë lidhet natyrshëm me gjetjet e mëparshme mbi pjesëmarrjen. Të rinjtë nuk duan të jenë vetëm përfitues të politikave për të rinjtë, por dëshirojnë të jenë bashkëbisedues dhe pjesëmarrës në hartimin e tyre. Kur flasin për qëndrimin, ata nuk flasin vetëm për ekonominë dhe aktivitetet, por edhe për nevojën që komuniteti t'i shohë si aktorë të rëndësishëm. Përfshirja aktive e të rinjve në vendimmarrje forcon angazhimin e tyre dhe rrit ndjenjën e përkatësisë, përgjegjësisë dhe besimit te komuniteti. Ata zgjedhin të qëndrojnë aty ku zëri i tyre dëgjohej.

Përgjigjet tregojnë gjithashtu se një pjesë e të rinjve e lidhin qëndrimin me sigurinë, transportin publik më të mirë dhe përmirësimin e infrastrukturës. Këto tema mund të duken më pak simbolike sesa arsimit apo punësimi, por janë shumë të rëndësishme për jetën e përditshme. Cilësia e rrugëve, ndriçimi publik, hapësirat publike, mundësia e lëvizjes, transporti funksional, qasja në përmbajtje dhe ndjenja e sigurisë krijojnë bazën e përvojës së përditshme të jetës në qytet. Të rinjtë nuk marrin vendime për të qëndruar vetëm në bazë të synimeve të mëdha jetësore, por edhe në bazë të mënyrës se si qyteti përjetohet në përditshmërinë e tyre: nëse është praktik, i qasshëm, i gjallë, i sigurt dhe i përshtatur me nevojat e tyre.

Në disa përgjigje vërehet gjithashtu nevoja për praktika profesionale, sipërmarrje dhe zhvillim profesional. Të rinjtë duan mundësi për të fituar përvojë para se të hyjnë zyrtarisht në tregun e punës. Ata kërkojnë praktika profesionale, mbështetje nga mentorë, mundësi për të zhvilluar idetë e tyre dhe programe që i lidhin me botën e punës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, sepse tregon se të rinjtë nuk kërkojnë vetëm zgjidhje të gatshme, por duan një hapësirë ku mund të zhvillohen, të provojnë veten dhe të ndërtojnë identitetin e tyre profesional. Një qytet që u ofron të rinjve praktikë, mbështetje për sipërmarrje dhe mundësi për të fituar përvojë, bëhet shumë më lehtë një qytet ku ata mund ta imagjinojnë të ardhmen e tyre.

Kur të gjitha këto mesazhe mbledhen së bashku, bëhet e qartë se të rinjtë në Ulqin nuk e shohin qëndrimin si një gjest emocional, por si një vendim real jetësor. Qëndrimi, nga këndvështrimi i tyre, duhet të mbështetet në mundësi konkrete. Kjo do të thotë se qyteti duhet të jetë një vend ku ekzistojnë mundësi punësimi dhe zhvillimi, por edhe një vend ku ekzistojnë aktivitete, rregulla të barabarta për të gjithë, institucione të hapura, hapësira për të rinjtë, jetë kulturore dhe sportive, mundësi praktike, arsim dhe funksionalitet në jetën e përditshme. Të rinjtë nuk kërkojnë që Ulqini të jetë një qytet i përsosur. Ata kërkojnë kushte themelore që t'u mundësojnë të planifikojnë jetën pa ndjenjën se për çdo mundësi të rëndësishme duhet të largohen diku tjetër.

Ky kapitull ka një rëndësi të veçantë pasi përmbyll të gjithë ciklin e hulumtimit. Nëse në fillim u ngrit pyetja se sa mundësi u ofron Ulqini të rinjve në arsim, aktivizëm, pjesëmarrje dhe zhvillim, në fund – përmes përgjigjeve të hapura – vetë të rinjtë e përmbledhin këtë panoramë në një mesazh të thjeshtë: qëndrimi në vendlindje do të jetë i mundur vetëm atëherë kur jeta aty të garantojë një të ardhme të sigurt dhe dinjitoze.

Përfshirja aktive e të rinjve në vendimmarrje forcon angazhimin e tyre dhe rrit ndjenjën e përkatësisë, përgjegjësisë dhe besimit te komuniteti. Ata zgjedhin të qëndrojnë aty ku zëri i tyre dëgjohej.

Qëndrimi në vendlindje do të jetë i mundur vetëm atëherë kur jeta aty të garantojë një të ardhme të sigurt dhe dinjitoze.

REZULTATET KRYESORE

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se të rinjtë në Ulqin e dinë shumë mirë se çfarë u mungon, për çfarë kanë nevojë dhe se cilat janë rrethanat që do t'i mbanin në qytetin e tyre për të ndërtuar të ardhmen. Përgjigjet e tyre nuk dëshmojnë pasivitet, por një kërkesë të fortë për mundësi më konkrete, përfshirje më të madhe dhe programe më cilësore. Të rinjtë nuk mjaftohen vetëm me numërimin e problemeve; përmes zërit të tyre ata vetë ofrojnë rrugëzgjdhje.

Rezultati i parë lidhet me arsimin dhe përgatitjen për tregun e punës. Shumica e të rinjve ndiejnë se arsimi nuk u ofron mbështetjen e duhur për integrimin e ardhshëm në treg dhe zhvillimin profesional. Gjithsej 70,6% e të anketuarve konsiderojnë se arsimi i përgatit për tregun e punës më së shumti deri në nivelin „mesatar“, ndërsa vetëm një pjesë e vogël e të rinjve mendojnë se arsimi i përgatit plotësisht për atë që i pret pas shkollës apo fakultetit. Ky rezultat shpreh nevojën që arsimi të ndërlidhet më fuqishëm me aftësitë praktike, orientimin në karrierë, përvojën e punës dhe nevojat reale të të rinjve.

Rezultati i dytë dëshmon për rëndësinë e madhe të edukimit joformal. Plot 92,6% e të rinjve kanë marrë pjesë në aktivitete jashtëshkollore, si klube debati, kampe edukative, punëtori, trajnime apo aksione rinore. Për më tepër, 83,0% e të rinjve deklarojnë se kjo përvojë u ka ndihmuar shumë për të fituar aftësi të reja. Nga kjo kuptojmë se të rinjtë e njohin vlerën e të mësuarit joformal dhe se programe të tilla mund të jenë një nga shtyllat më të rëndësishme për zhvillimin e kompetencave, vetëbesimit dhe pjesëmarrjes së tyre aktive në komunitet.

Rezultati i tretë lidhet me aktivitetet për të rinj dhe cilësinë e jetës së përditshme. Të rinjtë në Ulqin bëjnë të qartë se u mungojnë hapësirat, programet dhe aktivitetet që janë të qasshme gjatë gjithë vitit. Në përgjigjet e hapura përmenden shpesh qendra rinore, programe edukative dhe kulturore, kinema, koncerte, terrene sportive dhe aktivitete që nuk lidhen vetëm me sezonin e verës.

Rezultati i katërt tregon se aktivitetet sportive dhe kulturore nuk janë të zhvilluara ose të aksesueshme aq sa duhet. Pothuajse nëntë në dhjetë të rinj merren rregullisht ose herë pas here me sport apo aktivitete rekreative, por në të njëjtën kohë 59,9% e të anketuarve konsiderojnë se në Ulqin nuk ka mjaftueshëm hapësira dhe aktivitete sportive. Kjo mospërputhje mes interesit të të rinjve dhe infrastrukturës aktuale dëshmon nevojën e madhe për investim në terrene sportive, zona rekreative, palestra, programe që do t'u mundësonin të rinjve një mënyrë më cilësore e më të shëndetshme të kalimit të kohës së lirë.

Rezultati i pestë lidhet me pjesëmarrjen e të rinjve. Një numër i konsiderueshëm i të rinjve nuk ndihet mjaftueshëm të përfshirë në proceset lokale të vendimmarrjes. Gjithsej 70,3% e të anketuarve besojnë se pushteti lokal nuk i përfshin të rinjtë ose i përfshin vetëm pjesërisht në vendimet që lidhen me interesat e tyre. Ky është një sinjal i qartë se format e sotme të komunikimit dhe përfshirjes nuk janë mjaftueshëm të dukshme apo të qasshme. Të rinjtë nuk duan të jenë thjesht përfutës pasivë, por bashkëbisedues dhe pjesëmarrës aktivë në vendimmarrje.

Rezultati i gjashtë, megjithatë, tregon një potencial të fuqishëm për pjesëmarrje. Edhe pse të rinjtë nuk ndihen të përfshirë mjaftueshëm, shumica e tyre shfaqin gatishmëri për të marrë pjesë. Dy të tretat e të rinjve kanë marrë pjesë tashmë në ndonjë iniciativë, projekt ose aktivitet që lidhet me pozitën e të rinjve, ndërsa 96,8% e tyre tregojnë gatishmëri për pjesëmarrje të ardhshme në projekte dhe iniciativa që u mundësojnë të ndikojnë në vendimet në qytet. Ky rezultat përputhet plotësisht me misionin e projektit 'Liderët e rinj: nga ideja te ndikimi', pasi dëshmon se në Ulqin ekziston një gjeneratë që dëshiron të kontribuojë, por ka nevojë për hapësirë më të qartë për veprim.

Rezultati i shtatë pasqyron qëllimet e të rinjve në lidhje me emigrimin. Gjithsej 59,8% e të rinjve deklarojnë se është e mundshme ose shumë e mundshme të ardhmen e tyre ta ndërtojnë jashtë Ulqinit. Një rezultat i tillë nuk domethënë se të rinjtë nuk e duan qytetin e tyre, por dëshmojnë se shumë prej tyre nuk shohin mundësi reale për të ndërtuar të ardhmen këtu. Largimi nga qyteti i lindjes nxitet kryesisht nga faktorë të tillë si pamundësia për t'u zhvilluar profesionalisht, mungesa e alternativave arsimore dhe vështirësitë në punësim.

Rezultati i tetë tregon qartë se çfarë do t'i mbante të rinjtë në Ulqin. Përgjigjet e hapura tregojnë se të rinjtë e lidhin qëndrimin kryesisht me punësim cilësor dhe të qëndrueshëm, mundësi më të mira arsimimi, aktivitete dhe përmbytje për të rinjtë, infrastrukturë sportive dhe kulturore, përfshirje më të madhe në vendimmarrje dhe cilësi më të mirë jetese. Të rinjtë nuk kërkojnë privilegje, por thjesht kushte që e bëjnë qëndrimin në vendlindje një zgjedhje të logjishme dhe dinjitoze.

Gjetjet e këtij hulumtimi dëshmojnë se të rinjtë në Ulqin duan të bëhen pjesë e ndryshimit, por gatishmëria e tyre duhet të shoqërohet me mundësi konkrete. Dashuria për vendlindjen nuk mjafton për t'i mbajtur ata këtu; qyteti duhet t'u sigurojë arsimim, punë, hapësira sociale e sportive, si dhe besimin se ata mund të jenë bashkëautorë të vendimmarrjes në komunitetin e tyre.

REKOMANDIMET

Ky hulumtim tregon qartë se ndryshimi i gjendjes së të rinjve në Ulqin nuk mund të vijë si një përpjekje e izoluar; ai kërkon një bashkëpunim të ngushtë dhe ndërveprim shumëpalësh. Nevojat e të rinjve nuk lidhen vetëm me një fushë të caktuar, prandaj edhe rekomandimet nuk mund të synojnë vetëm një sektor. Arsimi, punësimi, koha e lirë, sporti, kultura, pjesëmarrja dhe zhvillimi lokal duhet të shihen si procese të ndërlidhura.

Rekomandime për vetëqeverisjen lokale

Vetëqeverisja lokale luan një rol kyç në krijimin e një ambienti ku të rinjtë mund të jenë pjesëmarrës aktivë në zhvillimin lokal.

Rekomandimi i parë është ngritja e një mekanizmi të përhershëm për konsultimin e të rinjve. Ky mekanizëm mund të jetë një këshill rinor, një forum i rregullt rinor, konsultime vjetore me nxënësit e shkollave të mesme, studentët dhe të rinjtë e punësuar, ose një platformë digjitale përmes së cilës ata mund të propozojnë ide dhe të komentojnë vendimet lokale. Përfshirja e të rinjve duhet të mos jetë e rastësishme dhe thjesht formale, por e rregullt, e qartë dhe e lidhur me procese konkrete të vendimmarrjes.

Rekomandimi i dytë është mbështetja për themelimin e një qendre rinore ose të një hapësire të përhershme për të rinjtë. Rezultatet e hulumtimit tregojnë qartë se të rinjtë kërkojnë një vend ku mund të mblidhen, të mësojnë, të organizojnë aktivitete, të zhvillojnë ide dhe ta kalojnë kohën në mënyrë cilësore. Një hapësirë e tillë nuk duhet të jetë vetëm një lokacion fizik, por një qendër rinore funksionale (hub) që ndërlidh edukimin, kulturën, aktivizmin, kreativitetin, këshillimin për karrierë dhe mbështetjen e ndërsjellë mes bashkëmoshatarëve.

Rekomandimi i tretë është hartimi i një kalendari vjetor të aktiviteteve kulturore, sportive dhe edukative për të rinjtë. Të rinjtë e veçojnë si problem natyrën sezonale të aktiviteteve dhe mungesën e përmbajtjeve gjatë gjithë vitit. Kalendari i aktiviteteve duhet të jetë i qasshëm për publikun, i komunikuar qartë dhe i krijuar në bashkëpunim me vetë të rinjtë.

Rekomandimi i katërt është përfshirja e të rinjve në hartimin e strategjive lokale, planeve të veprimit dhe prioritetëve buxhetore që lidhen me arsimin, sportin, kulturën, punësimin dhe politikat rinore. Të rinjtë duhet të përfshihen që nga fillimi i procesit, jo pasi dokumenti është hartuar tashmë. Në këtë mënyrë rritet ndjenja e pronësisë mbi politikat lokale dhe besimi se pjesëmarrja e tyre ka një impakt domethënës.

Rekomandimi i pestë synon ta bëjë sportin dhe rekreacionin më të qasshëm për të gjithë. Kjo kërkon investime në ndërtimin e terreneve sportive, zonave rekreative, palestrave shkollore dhe hapësirave të hapura për aktivitet fizik. Njëkohësisht, duhen krijuar programe që nxisin përfshirjen e të rinjve jashtë klubeve zyrtare, me fokus të veçantë te vajzat, të rinjtë nga zonat rurale dhe ata me mundësi më të kufizuara socio-ekonomike.

Rekomandimi i gjashtë është ndërlidhja e politikave rinore me politikat e punësimit dhe të zhvillimit ekonomik lokal. Duke qenë se të rinjtë qëndrojnë më gjatë në qytet e lidhin kryesisht me punën, vetëqeverisja lokale duhet të zhvillojë masa mbështetëse për sipërmarrësit e rinj, programe të praktikës profesionale, bashkëpunim me punëdhënësit lokalë dhe iniciativa që u mundësojnë të rinjve të fitojnë përvojën e tyre të parë të punës.


Rekomandime për institucionet arsimore

Institucionet arsimore luajnë një rol vendimtar në përafrimin e arsimit formal me nevojat praktike të të rinjve.

Hapi i parë drejt kësaj është shtimi i orëve praktike që zhvillojnë shkathtësi të dobishme për jetën e përditshme dhe karrierën, siç janë: shkrimi i CV-së, përgatitja për intervistë pune, të folurit publik, komunikimi, puna në grup, financat, aftësitë digjitale, menaxhimi i kohës dhe kuptimi bazë i tregut të punës.

Rekomandimi i dytë është fuqizimi i këshillimit për karrierë. Të rinjtë duhet të marrin informacione më herët mbi mundësitë arsimore dhe profesionale, veçanërisht në periudhën kur zgjedhin shkollën e mesme, fakultetin apo punën e parë. Këshillimi për karrierë duhet të jetë praktik, i qasshëm dhe i lidhur me mundësitë reale në komunitetin lokal e më gjerë.

Rekomandimi i tretë është ndërlidhja e të rinjve me punëdhënësit, praktikantët dhe programet e zhvillimit profesional. Shkollat dhe institucionet arsimore mund të kenë një rol të rëndësishëm në organizimin e vizitave nëpër kompani, ditëve të karrierës, panairëve të punës, praktikave profesionale, mentorimit dhe takimeve me njerëz të profesioneve të ndryshme. Programe të tilla i ndihmojnë të rinjtë të kuptojnë se çfarë i pret pas përfundimit të arsimit formal.



Rekomandimi i katërt është zhvillimi i aftësive digjitale, të komunikimit dhe atyre ndërmarrëse. Përgjigjet e hapura tregojnë se të rinjtë dëshirojnë njohuri nga fusha e teknologjisë së informacionit, inteligjencës artificiale, programimit, gjuhëve të huaja, të folurit në publik, sipërmarrjes dhe arsimimit financiar. Këto tema duhet të përfshihen më shpesh në aktivitetet jashtëshkollore dhe në programet shkollore të mbështetjes.

Rekomandimi i pestë është fuqizimi i programeve për shëndetin mendor dhe mbështetjen psiko-sociale. Të rinjtë në përgjigjet e tyre e vlerësojnë rëndësinë e vetëbesimit, menaxhimit të stresit, shëndetit mendor, jetës së shëndetshme. Shkollat duhet të zhvillojnë programe që i ndihmojnë të rinjtë të përballen me presionin, pasigurinë, marrëdhëniet me bashkëmoshatarët, përzgjedhjet arsimore dhe planifikimin e së ardhmes.

Rekomandime për OJQ-të dhe organizatat rinore

Organizatat joqeveritare dhe ato rinore luajnë një rol të veçantë pasi që janë në kontakt të afërt me të rinjtë dhe nevojat e tyre reale.

Rekomandimi i parë është vazhdimi dhe zgjerimi i programeve të edukimit joformal. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se të rinjtë e shohin edukimin joformal si shumë të dobishëm, prandaj programet e punëtorive, trajnimeve, kurseve dhe projekteve rinore duhet të zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme.

Rekomandimi i dytë është zhvillimi i programeve për udhëheqësinë dhe gjithëpërfshirjen. Të rinjtë shfaqin interes të lartë për të marrë pjesë në iniciativa, por kanë nevojë për mbështetje për t'i shndërruar idetë e tyre në aksione konkrete. Programet duhet të trajtojnë tema si lidhshipi, puna në grup, planifikimi i projekteve, komunikimi me institucionet, proceset lokale të vendimmarrjes.

Rekomandimi i tretë është përfshirja e të rinjve në planifikimin e aktiviteteve, dhe jo vetëm në realizimin e tyre. Të rinjtë nuk duhet të jenë thjesht pjesëmarrës në aktivitete, por të bashkëpunojnë me organizatorët, të konceptojnë temat, metodat, formatin dhe qëllimet e programeve. Në këtë mënyrë, aktivitetet bëhen më relevante, ndërsa të rinjtë zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë dhe të pronësisë.

Rekomandimi katërt është fuqizimi i bashkëpunimit midis sektorit të OJQ-ve, shkollave, vetëqeverisjes lokale dhe të rinjve. Pozita e të rinjve nuk mund të përmirësohet përmes aktiviteteve të izoluar. Është e nevojshme të krijohen partneritete që ndërlidhin burime të ndryshme: hapësirën, ekspertizën, mbështetjen institucionale, komunikimin me të rinjtë dhe financimin.

Rekomandime për mediat dhe komunitetin e gjerë

Përmirësimi i pozitës së të rinjve nuk është vetëm përgjegjësi e institucioneve dhe organizatave. Mediat dhe komuniteti i gjerë luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e një kulture ku të rinjtë identifikohen si anëtarë të vlefshëm, të aftë dhe relevantë të shoqërisë.


Rekomandimi i parë fokusohet te rritja e pranisë së të rinjve në mediat lokale. Evidentimi i arritjeve të tyre në fusha të ndryshme shërben si burim frymëzimi për moshatarët dhe ndërton një imazh më pozitiv për kontributin e tyre në shoqëri.

Rekomandimi i dytë synon që mediat t'u kushtojnë më shumë hapësirë çështjeve që prekin të rinjtë. Përtej raportimit të thjeshtë të ngjarjeve, nevojitet një diskutim i vazhdueshëm mbi sfidat e tyre — si punësimi, arsimi, strehimi dhe shëndeti mendor. Zëri i të rinjve duhet të jetë pjesë e pandarë e hapësirës publike gjatë gjithë vitit, e jo vetëm në raste sporadike.

Rekomandimi i tretë fokusohet te përfshirja më aktive e të rinjve në krijimin e përmbajtjeve mediatike dhe në diskutimet publike. Të rinjtë nuk duhet të shihen thjesht si subjekt i kronikave mediatike, por si bashkëbisedues, autorë dhe pjesëmarrës aktivë në debatet mbi çështjet që i prekin drejtpërdrejt. Kjo qasje forcon vetëbesimin e tyre dhe njëkohësisht ngre cilësinë e dialogut publik.

Rekomandimi i katërt synon kultivimin e një mjedisi të bazuar te meritokracia, profesionalizmi dhe përgjegjësia sociale. Për të nxitur një debat të shëndoshë dhe për të gjetur zgjidhje afatgjata, ky udhëzues kërkon që të adresohen hapur problemet që prekin të rinjtë, si pabarazia në tregun e punës, ndikimet politike dhe nepotizmi.

Rekomandimi i pestë synon që mediat dhe komuniteti lokal të promovojnë vazhdimisht idenë se të rinjtë nuk janë thjesht e ardhmja e qytetit, por një pjesë thelbësore e tij që sot. Nismat, propozimet dhe nevojat e tyre duhet të bëhen të dukshme për publikun, duke i njohur të rinjtë si partnerë të barabartë në planifikimin dhe zhvillimin e komunitetit.



KONKLUZIONI:

TË RINJTË NË ULQIN NUK KËRKOJNË PRIVILEGJE, POR MUNDËSI

Hulumtimi tregon se të rinjtë në Ulqin shfaqin interes, ide, përvojë dhe gatishmëri për të marrë pjesë në zhvillimin e komunitetit të tyre. Ata nuk janë vëzhgues pasivë të jetës lokale. Në të vërtetë, ata marrin pjesë në trajnime, njohin rëndësinë e arsimit joformal, merren me sport dhe rekreacion, shfaqin interesim për projekte e iniciativa dhe flasin qartë se çfarë duhet ndryshuar që Ulqini të bëhet një vend më i mirë për të rinjtë.

Motivimi i tyre përballët me mundësi të kufizuara. Të rinjtë vënë në dukje përgatitjen e pamjaftueshme praktike për tregun e punës, mungesën e mundësive cilësore arsimore dhe profesionale, aktivitetet sportive, kulturore dhe edukative të pazhvilluara sa duhet, mungesën e hapësirave për të rinjtë dhe ndjenjën se nuk janë të përfshirë mjaftueshëm në vendimmarrjen lokale. Këto gjetje tregojnë se problemi nuk qëndron te mungesa e potencialit të të rinjtë, por te mungesa e një sistemi që e identifikon dhe e mbështet mjaftueshëm këtë potencial.

Synimet e të rinjve për të emigruar nuk dëshmojnë mungesë dashurie për qytetin e vet, por mungesë perspektive. Ata nuk largohen nga dëshira për ta braktisur vendlindjen, por nga pamundësia për të ndërtuar një jetë të qëndrueshme këtu. Prandaj, vendimi për të qëndruar nuk është thjesht një zgjedhje personale, por një sfidë për komunitetin, i cili duhet t'u ofrojë arsye reale për të mos u larguar.

Mbajtja e të rinjve në Ulqin nuk mund të arrihet përmes masave të izoluara, por kërkon një qasje shumëdimensionale. Kjo nënkupton ndërtimin e urave të forta mes arsimit dhe tregut të punës, krijimin e një ekosistemi stimulues me hapësira e aktivitete për t'u zhvilluar, si dhe garantimin e mundësive të barabarta për sipërmarrje dhe përfshirje reale në vendimmarrje.

Ky hulumtim nxjerr në dritë një brez të rinjve që ka se çfarë të thotë. Zëri i tyre në Ulqin vjen si një paralajmërim për mungesën e një perspektive të qartë në qytet, por edhe si një mundësi e madhe, pasi dëshmon se ata janë gati të kontribuojnë për ndryshimin. Sfidë tashmë mbetet që këto rezultate të mos mbeten thjesht në letër, por të përkthehen në politika publike, programe dhe hapësira konkrete veprimi.

Kërkesat e të rinjve janë të qarta: arsim cilësor, punësim dinjitoz, një qytet aktiv në çdo stinë dhe institucione që i dëgjojnë e u krijojnë hapësirë. Nëse Ulqini i kthen këto nevoja në prioritetë zhvillimore, rinia nuk do të jetë më thjesht një grup që duhet mbajtur me çdo kusht, por forca motorike që e çon qytetin përpara.



NEW HORIZON
Civil Society Organization



+382 68 300 603



ngohorizonti@t-com.me



www.ngo-horizonti.org



newhorizontiongo



New Horizon NGO



newhorizon_ngo